



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Rrjetin Akademik Shqiptar”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2023”

Tiranë Maj 2024

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.	Hyrje	3
	1. Objekti i auditimit	4
	2. Qëllimi i auditimit	4
	3. Metodologjia e auditimit	4
	4. Konkluzione	5
	5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5
III.	Zbatimi i Rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	5
	1. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit të auditimit	5
	2. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes	5
	3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit	5
	4. Realizimi i rekomandimeve	6-12
IV.	Konkluzione dhe Rekomandime	12-13

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SH.A, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Instituti i Sigurimeve dhe Rrjeti Akademik Shqiptar”, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si: vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisione disiplinore për dhënien e masave disiplinore.
- Hartimin e programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjor për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.154/205 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për Shpërblim dëmi ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.

Kuadri ligjor dhe nënligjor i verifikimit të zbatimit rekomandimeve:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC
- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Manualët e Auditimit, Rregulloret, Udhëzimet e KLSH-së.

II. HYRJE

Auditimi u krye në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2, e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Programit të Auditimit nr. 223/4 prot., datë 08.02.2024 me

objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për marrjen e masave organizative, dhe të masave të tjera, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH-ja për misionet e mëparshme realizuar në subjektet UKT, ISHTI, ISSH dhe RASH.

Auditimi është kryer nga:

1. K.S, përgjegjës grupi
2. M.P, anëtare
3. A.K, anëtare
4. A.A, anëtar
5. D.B, anëtar

Çështjet e Audituar:

1. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (germa “j” e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”).

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014).

2. Realizimi i rekomandimeve për *ndryshime apo përmirësime në legjislacionin* në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

3. Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

II.1. Objekti i auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (terren) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, etj.

II.2. Qëllimi i auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë

e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësive në të ardhmen.

II.4. Konkluzione

Në përfundim të procesit të punës audituese në terren nga subjekti i audituar nuk u paraqiten kundërshti mbi aktverifikimin e mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.

Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 10 masa. Janë zbatuar 8 masa, është në proces zbatimi 1 masë organizative dhe është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative.

II.5. Opinioni i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Pavarësisht nga puna e bërë, niveli i realizimit të rekomandimeve është 80%, për disa nga masat për të cilat janë në proces zbatimi ose janë zbatuar pjesërisht duhet më shumë punë për realizimin e tyre në nivelin 100% të rekomandimeve.

III. Zbatimi i Rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

III.1. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

I. Rrjetin Akademik Shqiptar - RASH

Nga KLSH, me shkresën nr. 74/6 prot, datë 13.06.2023 për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 10 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 10 masa organizative. Janë zbatuar 8 masa organizative, është në proces zbatimi 1 masë organizative dhe është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative.

III.2 Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 74/6 prot, datë 13.06.2023, është dërguar “Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Rrjetin Akademik Shqiptar”. Drejtuesi i RASH ka nxjerrë Urdhrin nr. 6, datë 15.06.2023, për ngarkimin e departamenteve përkatëse për të hartuar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Megjithatë, në drejtim të KLSH nuk ka ardhur një përgjigje zyrtare në respektim të afatit ligjor prej 20 ditësh.

III.3 Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 74/6 prot, datë 13.06.2023, është dërguar “Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Rrjetin Akademik Shqiptar”. RASH nuk ka kthyer përgjigje zyrtare brenda afateve për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH brenda 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit.

III.4 Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

Nga të pranuarat	Nr.	%
Zbatuar	8	80
Zbatuar pjesërisht	1	10
Në proces	1	10
Nuk janë zbatuar	-	-

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse në auditimin e mëparshëm për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej **10** masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht **10** masa ose **100%** masa organizative. Janë zbatuar plotësisht **8** masa ose **80%** masa organizative, është në proces zbatimi **1** masë ose **10%** masa organizative dhe është zbatuar pjesërisht **1** masë ose **10%** masa organizative.

Më hollësisht, auditimi i zbatimit të rekomandimeve:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe IAL-të, e kanë vendosur Rrjetin Akademik Shqiptar në kushtet e riskut të ekzistencës së tij, pasi nuk kanë financuar për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve informatike që u ka ofruar, në kundërshtim me VKM nr.88, datë 14.02.2018, në pikën 5 ku citohet se:

“Burimet e financimit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar janë:

c. kontributi vjetor i anëtarësisë nga IAL-të dhe institucionet e tjera;

ç. kontributi vjetor i ministrisë përgjegjëse për arsimin, i agjencive dhe IAL-ve, sipas shërbimeve përkatëse të ofruara”.

1.1.Rekomandimi: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Institucione e Arsimit të Lartë, si anëtarë të asamblesë së Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për të vënë në funksion të administrimit të tyre akademik dhe administrativ produktet informatike që janë zhvilluar nga RASH si asete të rëndësishme në drejtim të inovacionit dhe të bashkëpunojnë në mënyrë aktive në përmirësimin e tyre, pasi vetëm në këtë mënyrë do të mund të informatizojnë më shumë procese dhe me më pak kosto financiare.

Nga auditimi rezulton se: RASH ka nisur bashkëpunimin me IAL-të me anë të marrëveshjeve për të vënë në dispozicion të këtyre të fundit produktet informatike dhe ofrimin e shërbimeve online.

Rekomandimi është në proces

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi strukturën e ngritur të sistemit “Pitagora” u konstatua se:

- Përdoruesve të sistemit me kërkesë të tyre ju është dhënë aksesimi për fshirje të të dhënave nga ndërfaqja. Nga kjo e drejtë, krijohen disa problematika të cilat i adresohen për zgjidhje RASH-it, duke rritur nevojën për suport të shpeshtë në rikthimin e të dhënave.

Programi Pitagora është konceptuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që kurrikula të lëvizet nga një program në një tjetër e gjithashtu t’i ndryshohet emri nëse është e nevojshme. Kjo do të thotë se veprimet e fshirjes nuk ka asnjë arsye të kryhen në sistem nga përdoruesit fundor që marrin këtë shërbim të cilët janë punonjës të universiteteve. Veprimi i fshirjes së Kurrikulës, në rastin kur është populluar me të dhënat e studentit, shoqërohet dhe me fshirjen e të dhënave të studentit/studentëve për këtë kurrikulë. Modifikimi i kurrikulës rezulton të jetë problemi më shpesh i raportuar dhe më me impakt tek të gjithë përdoruesit në lidhje me përdorimin e sistemit “Pitagora”.

Fshirja e kurrikulës ndodh nisur nga fakti se mungon parametrizimi në sistemin Pitagora për lejimin e fshirjes, pasi nuk është bërë një ndarje e këtij veprimi sipas popullimit, në mënyrë që:

- a. Fshirja e kurrikulës kur ajo sapo është krijuar, pra në kushtet kur të dhënat e studentit nuk janë populluar;
- b. Fshirja e kurrikulës kur ajo është vendosur në programin e gabuar, por ka dhe të dhënat e studentit.

Nga auditimi mbi krijimin, plotësimin si dhe fshirjen e kurrikulës u konstatua se:

- Gjatë plotësimit të të dhënave në fushën “*Mënyra e vlerësimit*” është vendosur si një nga mënyrat dhe opsioni “Mbrotjtje Anglishteje”, në vend të mbrotjtje gjuhë e huaj duke qenë se MAS ka një listë gjuhësh të miratuara si të detyrueshme për programet studimore për tipin “Master”.

- Në krijimin e një kurrikule nuk përcaktohet tipi i saj nëse është “*Provim*” apo “*Firmë*”.

- Nuk shfaqet mesazh gabimi në rast se veprohet nga përdoruesi për ndryshimin e kodit të lëndës në modulin “*Lëndët*”, megjithëse ndryshimet nuk ruhen kur kodit i përket një lëndë tjetër.

- Tek regjistrimi i elementëve mësimor në modulin “Programet” lista e elementëve është me shkurtime dhe jo emërtime të plota si: Leksion, Seminar, Praktikë, Ushtrime, Laboratorë, etj.

2.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për sistemimin e problematikave të konstatuara nga auditimi në modulin “*Programe*” të sistemit Pitagora. Gjithashtu, të ri konceptohet kodit i ndërtuar për fshirjen e kurrikulës duke mbajtur në konsideratë që fshirja të mos ndodhë në asnjë rast kur kurrikula është populluar me të dhëna për studentin, por të lejohen lëvizjet e saj në programe të ndryshme dhe modifikimet në të dhëna që lejohet ndryshimi.

Nga auditimi rezulton se: RASH ka marrë masat për sistemimin e problematikave të konstatuara nga auditimi në modulin “*Programe*” të sistemit Pitagora, si dhe ka rikonceptuar kodin e ndërtuar për fshirjen e kurrikulës.

Rekomandimi është zbatuar

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemin “*Pitagora*”, konkretisht në modulin “*Studentët/Regjistrimi manual i studentëve*”, u konstatua se:

- Në modifikimet e të dhënave për studentët e importuar lejohen të bëhen modifikime në të gjitha fushat përveç programit. Fushat, ku mund të jetë i nevojshëm modifikimi janë: mbiemri, numri i matricullimit, e-mail, telefon, vendbanimi, gjendja civile.

- Fushat, të dhënat e të cilave zgjidhen nga një listë si “Programi” dhe “Gjendja e Studentit”, nuk janë të renditura sipas rendit alfabetik.

- Me zgjedhjen e gjendjes së studentit në fushën “Gjendja e Studentit”, nuk janë përcaktuar fushat tek të cilat mund të kryhen modifikime ose plotësime.

- Me zgjedhjen e opsionit “I transferuar” e cila tregon se studenti ka transferuar studimet nga një program në një tjetër, fusha që nevojitet të plotësohet është “Universiteti nga është transferuar” e cila nuk është e tipit listë, duke mundësuar që të dhënat të mos shkruhen në forma të ndryshme kur nevojitet të themi të njëjtin emërtim.

- Në listën e të dhënave të fushës “Gjendja e Studentit” janë vendosur disa emërtime në Italisht, kur gjuha e ndjekur në aplikacion është gjuha shqipe.

- Në fushën “Datëlindja”, ku plotësohet data e lindjes së studentit, nuk janë implementuar mesazhe informuese për përdoruesit në rastet e pasaktësisë në plotësimin e saj si shembull: data nuk është plotësuar në formatin e kërkuar, ose data e lindjes nuk mund të jetë më pak se 18 vite.

- Nuk janë implementuar kontrole kufizuese mbi karaktere speciale në fushat Emër, Atësi, Mbiemër. Plotësimi i këtyre të dhënave nuk mund të përmbajë karaktere speciale.

- Fushat “Shkolla e Mesme”, “Vendlindja” dhe “Shtetësia” nuk janë në formën listë, çfarë mundëson që të dhënat të mos shkruhen në forma të ndryshme për të njëjtin emërtim.
 - Në të gjitha fushat që mund të modifikohen, mund të plotësohen me operatorët logjikë OR dhe AND.
 - NID është një e dhënë e konceptuar si unike e cila nuk mund të ndryshohet pasi ka përfunduar regjistrimi i studentit, por kjo e dhënë është kërkuar të modifikohet nga disa universitete në rastet kur është regjistruar gabim apo është importuar nga të dhëna të sistemit të mëparshëm. Nga auditimi u konstatua se nuk janë shtuar kontrole paralajmëruese përpara ruajtjes së regjistrimit të studentit për të dhënë e NID si e dhënë e pandryshueshme, çfarë ndihmon përdoruesin të kontrollojë të dhënat e regjistruara.
- Nga auditimi mbi modulën “*Krijo Orar/ Orari Mësimor/ Orari jo periodik*”, dhe në modulën *Krijo Orar/ Orari Mësimor/ Orari për përsëritës* u konstatua se:
- Në opsionin e krijimit të orarit të provimeve, nuk janë implementuar kontrole parandaluese mbi formatin e datës së provimit në modulën.
 - Të dhënat që zgjidhen nga një listë si “Pedagogu”, nuk janë renditur sipas rendit.
 - Tek orari periodik mund të plotësohen të dhëna mbi orarin mësimor, por aktualisht është një funksionalitet që nuk është vënë në përdorim nga universitetet.

3.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në modulën “*Studentët/Regjistrimi manual i studentëve*” të sistemit Pitagora. Gjithashtu, të implementohen kontrole kufizuese të tipit “Error” apo informuese të tipit “Override” të cilat respektivisht parandalojnë apo njoftojnë për një kontroll të të dhënave që përdoruesi po regjistron, duke parandaluar gabime njerëzore e detyrimisht dhe nevojën për suport.

Nga auditimi rezulton se: RASH ka marrë masat për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në modulën “*Studentët/Regjistrimi manual i studentëve*” të sistemit Pitagora.

Rekomandimi është zbatuar

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemin “*Pitagora*”, konkretisht në modulën “*Evidencat*”, u konstatua se:

- Universitetet nuk kanë kërkuar raporte mbi të dhëna të ndryshme si: plani mësimor, totalin e leksioneve, totalin e seminareve, totalin e laboratorëve, totalin e praktikave për javë mësimi si dhe për vit akademik, Orët jashtë orarit etj.
- Evidencat identifikohen nëpërmjet një kodi dhe emërtimi, por nuk ka një fushë përshkrimi ku të jepen detaje përshkruese mbi të dhënat që gjenerohen me secilin prej raporteve, çfarë do lehtësonte ngarkesën e sistemit dhe informim paraprak për përdoruesin.

4.1.Rekomandimi: Rrjeti Akademik Shqiptar dhe Universitetet që marrin shërbim për sistemin Pitagora, të bashkëpunojnë në ndërtimin e raporteve specifike dhe të bazuara në kërkesa konkrete dhe të mos mjaftohen me raportet e ndërhuara aktualisht, duke mbajtur në konsideratë faktin që për çdo të dhënë hyrëse në sistem mund të gjenerohet një raport, çfarë do ju shërbente më tej të gjitha palëve në analiza, statistika si dhe vendimmarrje.

Nga auditimi rezulton se: Rrjeti Akademik Shqiptar ka marrë masat për ndërtimin e raporteve specifike në sistem dhe të bazuara në kërkesa konkrete.

Rekomandimi është zbatuar

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemin “*Mësues për Shqipërinë*”, u konstatua se:

- Tek “*Regjistrimi*”, mësuesi hap llogarinë personale për herë të parë. Për ngarkimin e dosjes është konceptuar një fushë në të cilën bashkëngjitet duke upload-uar dokumentet që mësuesi dorëzon në aplikim. Për t’ju ardhur në ndihmë përdoruesve që në këtë rast janë mësues, është vendosur një tutorial i cili udhëzon në anglisht se si të bëhen “zip” dokumentet për aplikim, gjuhë e cila nuk njihet nga çdo mësues.

- Nuk janë implementuar kontrole mbi datën e lindjes së mësuesit që plotësohet në regjistrimin fillestar të tij, që do të thotë se të dhënat e datës së lindjes mund të jenë çfarëdo.
- Në fushat që plotëson mësuesi për Emrin, Atësinë dhe Mbiemrin nuk janë implementuar kontrole të karaktereve numerike apo speciale, pra këto të dhëna mund të plotësohen duke vendosur karaktere të tipit: ‘,’/] etj.
- Fushat e detyrueshme nuk janë identifikuar me tregues specifik si “*” apo ngjyrë tjetër, e cila i tregon përdoruesit, se nuk mund të vazhdojë më tej pa bërë plotësimet e nevojshme. Për plotësimin e fushave të detyrueshme nuk janë implementuar kontrole me plotësimin e tyre hap pas hapi. Një kontroll është implementuar në butonin e fundit “regjistrohu”, që shërben për ruajtjen e aplikimit.
- Numri personal me numrin e pasaportës janë konceptuar në të njëjtën fushë, por këto dy numra nuk kanë të njëjtin format. Nisur nga kjo, nuk implementohen dot kushte parandaluese në hedhjen e të dhënave të sakta për formatin e NID-it dhe numrit të pasaportës.
- Nuk është vendosur një maskë orientuese për numrin që nevojitet të plotësohet nga përdoruesi si në rastin e datëlindjes.
- Me zgjedhjen e opsionit “Konfirmo s ‘kualifikimin / përjashtimin e kandidatit”, nuk ka një fushë të detyruar ku të jepen arsyet e refuzimit nga DRAP, të dhëna të nevojshme për DPAP- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
- Fusha “Shënim” është e njëjta fushë ku mund të shkruajnë apo ndryshojnë të gjitha nivelet e përdoruesve: DRAP – Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, DPAP- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe ZVAP- Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar. Pra, në këtë fushë shënim i kryer nga DRAP mund të ndryshohet nga DPAP apo ZVAP dhe anasjelltas, çfarë pengon shënimet të mbeten si rekorde për efekt kontrolli apo gjurme në secilën nga fazat e vlerësimit.

5.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në sistemin “Mësues për Shqipërinë”, me qëllim përmirësimin, strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse, duke minimizuar në këtë mënyrë parregullsi të përdoruesve dhe nevojën për suport.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 85/2, datë 19.04.2024: Për sa keni referuar ju bëjmë me dije se RASH e ka zbatuar kërkesën për shtimin fushës “Shënime” në çdo nivel vlerësues të dosjes.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa i përket fushës “Shënime” RASH ka marrë masa për shtimin e kësaj fushe, por për pjesën e opsionit “Konfirmo s ‘kualifikimin / përjashtimin e kandidatit” nuk është dhënë asnjë zgjidhje. Përsa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon dhe do të konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi portalin “Mësues për Shqipërinë”, u konstatua se:

- Në adresën: <https://mesuespershqiperine.al/VendePune/Vende>, ku publikohen vendet e lira të punës, kërkimet nuk janë dinamike dhe të pavarura nga njëra tjetra. Nuk është e mundur që të kërkohet mbi vendet bosh të punës në bazë profili, pa përcaktuar DRAP. Gjithashtu, nuk është e mundur të bëhet kërkim në bazë profili pa zgjedhur më parë ZVAP. Nga testimet u konstatua se., kërkimi është i bazuar sipas renditjes: Cakto DRAP-> Zgjidh ZVAP->Zgjidh Profilin. Vetëm pasi të jenë plotësuar të dhënat sipas renditjes më sipër, mund të shfaqet një rezultat mbi kërkimin.
- Tek përmbajtja e njoftimeve, ku publikohen njoftimet e nevojshme në funksion të portalit “Mësues për Shqipërinë”, në adresën <https://mesuespershqiperine.al/Njoftimes>, adresat e internetit ku gjendet njoftimi nuk janë të lidhura që të hapen me një klikim, por vetëm duke i hapur këto adresa në një faqe të re kërkimi.
- Në hapësirën e quajtur “Këndi i Mësuesit”, informacioni udhëzues që jepet për të afishuar rezultatet përfundimtare tregon se të dhënat filtrohen sipas numrit personal me të cilin

aplikanti është regjistruar në portal ose në mënyrë alternative me numrin personal të deklaruar në dosje, adresa <https://mesuespershqiperine.al/Home/Kendi>. Opsioni i dhënë në adresën e mësipërme tregon se një afishim të dhënash mund të bëhet duke vendosur numrin e letërnjoftimit, ndërsa teksti shpjegues sqaron se nevojitet të vendosni numrin personal ose numrin e pasaportës që keni deklaruar në dosje. Letërnjoftimi nuk është pjesë e të dhënave në dosje, prandaj ai nuk duhet të jetë në asnjë nga kërkimet.

- Përmbajtja dhe përgjigjet e pyetjeve më të shpeshta drejtuar përdorimit të portalit “Mësues për Shqipërinë” në adresën <https://mesuespershqiperine.al/FAQs>, në disa raste nuk është dhënë informacion i plotë dhe në mënyrë shteruese.

6.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në sistemin “Mësues për Shqipërinë”, me qëllim përmirësimin, strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse, çfarë do të minimizojë parregullsitë e përdoruesve, si dhe nevojën për suport.

Nga auditimi rezulton se: RASH ka marrë masa për adresimin dhe zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në sistemin “Mësues për Shqipërinë”, me qëllim përmirësimin, strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse, të cilat do të minimizojnë parregullsitë e përdoruesve, si dhe nevojën për suport.

Rekomandimi është zbatuar

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemin “Portali i Trajnimeve”, u konstatua se:

- Tarifa e trajnimit është një e dhënë që plotësohet nga agjencitë kur shtojnë një rekord të ri për trajnimin i cili më pas publikohet në portal. Në këtë fushë mund të shënohen dhe tekst megjithëse me këtë të dhënë nevojiten të zhvillohen statistika nga ana e RASH.

- Gjatë regjistrimit mbi llojin e trajnimit mundësitë e zgjedhjes janë: i Drejtpërdrejtë, online dhe i kombinuar. Këto opsione megjithëse fikse dhe të dërguara nga KAPT- Komisioni i Akreditimit të Programit të Trajnimit, nuk rezultojnë të jenë pjesë e një liste nga e cila agjencitë të mund të zgjedhin po ata e plotësojnë këtë të dhënë manualisht.

- Orari i fillimit dhe Orari i mbarimit është i tipit tekst, ndërkohë që duhet të ishte “Time”.

- KAPT-i dërgon të dhënat për modulet si dhe të dhënat për agjencitë ku në disa raste janë në anglisht. RASH nuk ka ndërtuar një model “template” për plotësimin e fushave me të dhëna që vijnë nga KAPT-i, duke përcaktuar në këtë mënyrë se cilat janë të dhënat e detyrueshme që nevojiten për sistemin e trajnimeve.

- Përdoruesit e të gjitha kategori ve nuk gjenerojnë të dhëna si output/raporte.

- Në aplikimin për trajnim që kryhet nga mësuesi të dhënat hyrëse për emrin, mbiemrin dhe numrin personal janë formatuar në tipin tekst, që do të thotë se si të dhëna lejohet të regjistrohen karaktere speciale.

- Mesazhi që del në aplikimin e mësuesit për zhvillimin e një trajnimi është se “*Të gjitha fushat janë të detyrueshme për t’u plotësuar*”, por aplikimi mund të ruhet pa plotësuar të dhëna mbi Institucionin Arsimor.

7.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për sistemimin e problematikave të konstatuara në sistemin “Portali i Trajnimeve”, duke përmirësuar në këtë mënyrë strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse e njëkohësisht duke minimizuar parregullsi të përdoruesve dhe nevojën për suport.

Nga auditimi rezulton se: RASH ka marrë masa për sistemimin e problematikave të konstatuara në sistemin “Portali i Trajnimeve”, me qëllim strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse e njëkohësisht minimizimin e parregullsive të përdoruesve dhe nevojën për suport.

Rekomandimi është zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemet informatike që ka ndërtuar RASH si “Pitagora”, “Mësues për Shqipërinë”, “Portali i Trajnimeve”, u konstatua se mungojnë:

- Diagramet e qarkullimit të informacionit për proceset e ofruara nëpërmjet këtij sistemi të cilat njihen ndryshe si Workflow, të cilat përcaktojnë hyrjen e informacionit, përpunimin dhe raportimin e tij;

- Në mënyrë të unifikuar shenjat simbolizuese në të dhënat e detyrueshme që kërkohen dhe njihen si “mandatory filed”, tipet e të dhënave mbi datën, kohën si dhe të dhënat e tipit listë të përcaktuara për të dhënat që janë me zgjedhje.

8.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për zgjidhjen e problematikave të njëjta që janë identifikuar gjatë auditimit në sistemet “Pitagora”, “Mësues për Shqipërinë” dhe “Portali i Trajnimeve”.

Nga auditimi rezulton se: RASH ka zbatuar rekomandimin për zgjidhjen e problematikave specifike të identifikuara gjatë auditimit në sistemet “Pitagora”, “Mësues për Shqipërinë” dhe “Portali i Trajnimeve”.

Rekomandimi është zbatuar

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se RASH nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT. Në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve. Institucioni nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për kryerjen e ndryshimeve.

9.1.Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Rrjetin Akademik Shqiptar të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve, problemeve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

Nga auditimi rezulton se: RASH ka marrë masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve bazuar në Urdhrin nr. 1, datë 18.03.2019, “Për miratimin e Rregullores për sigurinë e informacionit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”, ku në Aneksin 1 gjendet dhe “Formulari i raportimit të incidentit kibernetik”. Me anë të këtij formulari mund të dokumentohen dhe monitorohen incidentet.

Rekomandimi është zbatuar

10.1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Procedura e ndjekur për kryerjen e backup-ve nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në një dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesi i ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e RASH;

- RASH nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (Disaster Recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektiva të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPO-s (*Objektivat e Punës së Ripërtëritjes*) për çdo proces kritik.

10.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në RASH të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

Nga auditimi rezulton se: RASH ka marrë hapat përkatëse duke përcaktuar atributet dhe rolet e punonjësve në sistem sipas Urdhrit nr. 1, datë 18.03.2019, “Për miratimin e

Rregullores për sigurinë e informacionit të Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”.

Rekomandimi është zbatuar

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Akt Verifikimi nr. 1, datë 01.03.2024 protokolluar në RASH me nr. 85, datë 01.03.2024, si dhe është trajtuar në faqet 3-14 të Projekt Raportit të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara 6-mujorin e parë të vitit 2023” mbi të cilin janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit. Nga RASH janë paraqitur komente/ observacione me shkresën nr. 85/2, datë 19.04.2024, mbi sa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Përmbledhëse e Masave

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa Organizative	10	10	8	1	1	-

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes RASH-it i janë rekomanduar 10 masa organizative. Nga auditimi rezultoi se, nga masat organizative janë zbatuar 8 masa organizative, është në proces zbatimi 1 masë organizative dhe është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative. Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit që rezultoi i zbatuar pjesërisht si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 74/6 prot, datë 13.06.2023 drejtuar RASH, është zbatuar pjesërisht rekomandimi 5.1, si vijon:

5.1.Rekomandimi: Drejtuesit e institucionit të Rrjetit Akademik Shqiptar të marrin masa për zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga auditimi në sistemin “Mësues për Shqipërinë”, me qëllim përmirësimin, strukturimin dhe unifikimin e të dhënave hyrëse, duke minimizuar në këtë mënyrë parregullsi të përdoruesve dhe nevojën për suport.

1.1.Rekomandimi: Strukturat përkatëse të RASH, të marrin masat e nevojshme për rekomandimin e zbatuar pjesërisht me qëllim përsheptimin e procesit për zbatimin e plotë të tij.

Brenda 3-mujorit të II të vitit 2024 dhe në vijimësi

Të tjera

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2024, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e radhës që KLSH do kryejë në këto subjekte.

Për rekomandimin i cili ka rezultuar i zbatuar pjesërisht nga auditimi i ushtruar “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023*”, së bashku me pjesë nga Raporti Përfundimtar, do të përcillen në subjekt sipas Vendimit të Kryetarit për këtë auditim.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2023”

Tiranë Maj 2024

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.	Hyrje	3
	1. Objekti i auditimit	4
	2. Qëllimi i auditimit	4
	3. Metodologjia e auditimit	4
	4. Konkluzione	5
	5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5
III.	Zbatimi i Rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	5
	1. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	5
	2. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes	5
	3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit	5
	4. Realizimi i rekomandimeve	6-15
IV.	Konkluzione dhe Rekomandime	15

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SH.A, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Instituti i Sigurimeve dhe Rrjeti Akademik Shqiptar”, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si: vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisione disiplinore për dhënien e masave disiplinore.
- Hartimin e programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjor për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.154/205 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për Shpërblim dëmi ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.

Kuadri ligjor dhe nënligjor i verifikimit të zbatimit rekomandimeve:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC
- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Manualët e Auditimit, Rregulloret, Udhëzimet e KLSH-së.

II. HYRJE

Auditimi u krye në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2, e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Programit të Auditimit nr. 223/4 prot., datë 08.02.2024 me

objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për marrjen e masave organizative, dhe të masave të tjera, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH-ja për misionet e mëparshme realizuar në subjektet UKT, ISHTI, ISSH dhe RASH.

Auditimi është kryer nga:

1. K.S, përgjegjës grupi
2. M.P, anëtare
3. A.K, anëtare
4. A.A, anëtar
5. D.B, anëtar

Çështjet e Audituaras:

1. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (germa “j” e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”).

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014).

2. Realizimi i rekomandimeve për *ndryshime apo përmirësime në legjislacionin* në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

3. Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

II.1. Objekti i auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (terren) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, etj.

II.2. Qëllimi i auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë

e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

II.4. Konkluzione

Në përfundim të procesit të punës audituese në terren nga subjekti i audituar nuk u paraqiten kundërshti mbi aktverifikimin e mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 14 masa organizative. Janë zbatuar 3 masa organizative, janë në proces zbatimi 10 masa organizative dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative.

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Pavarësisht nga puna e bërë, niveli i realizimit të rekomandimeve është 21.4%, për disa nga masat për të cilat janë në proces zbatimi ose janë zbatuar pjesërisht duhet më shumë punë për realizimin e tyre në nivelin 100% të rekomandimeve.

III. Zbatimi i Rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

III.1. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

I. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial - ISHTI

Nga KLSH, me shkresën nr. 1189/6 prot, datë 09.05.2023 për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 14 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 14 masa organizative. Janë zbatuar 3 masa organizative, janë në proces zbatimi 10 masa organizative dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative.

III.2 Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 1189/6 prot, datë 09.05.2023, është dërguar “Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial”. ISHTI nuk ka dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit planin e masave për rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi auditimin e zhvilluar në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, duke mos respektuar afatin prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”. Vetëm një nga subjektet që ka qënë pjesë e auditimit, konkretisht IQ me shkresën nr. 1189/9, datë 02.06.2023, i pranon të gjitha rekomandimet që lidhen me të.

III.3 Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 1189/6 prot, datë 09.05.2023, është dërguar “Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial”. ISHTI ka dërguar shkresën nr. 3496/1, datë 08.11.2023, në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve duke respektuar afatin prej 6 muajsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

III.4 Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

Nga të pranuarat	Nr.	%
Zbatuar	3	21.4
Zbatuar pjesërisht	-	-
Në proces	10	71.4
Nuk janë zbatuar	1	7.2

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse në auditimin e mëparshëm për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej **14** masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht **14** masa ose **100%**. Janë zbatuar plotësisht **3** masa ose **21.4%** masa organizative, janë në proces zbatimi **10** ose **71.4%** masa organizative dhe është pa zbatuar **1** masë ose **7.2%** masa organizative.

Më hollësisht, auditimi i zbatimit të rekomandimeve:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk disponon një strategji institucionale, mungesa e të cilës sjell mangësi në vendosjen e prioriteteve të institucionit si dhe mungesën e pasqyrimin të objektivave të lidhura me burimet dhe instrumentet e nevojshme për matjen e tyre.

1.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë institucionale ku të përfshihen edhe elementë të teknologjisë së informacionit, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e objektivave institucionale.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Me Urdhër të Kryeinspektorit Nr. 68, datë 17.04.2024 është ngritur grupi i punës për hartimin e Strategjisë institucionale të ISHTI-t.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit duke qenë se ISHTI së fundmi ka marrë masa për ngritjen e një grupi pune për hartimin e strategjisë institucionale, vlerësojmë se ky rekomandim do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces

2.Gjetje nga auditimi: Rregullorja e brendshme institucionale nuk përputhet me veprimtarinë reale të ISHTI-t, pasi në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të ISHTI-t nuk janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e gjithsecilit. Rregullorja fokusohet deri në nivelin e përcaktimit të rregullave të përgjithshme të strukturave dhe nuk përshkruan detyrat e strukturave të brendshme.

2.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa për përditësimin e rregullores së brendshme, në të cilën të reflektohen dhe pasqyrohen ndryshimet institucionale strukturore, rregullat, detyrat si dhe përshkrimet e punës të të gjithë punonjësve të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Me anë të shkresës drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me Nr. 820 Prot., datë 19.01.2024, me lëndë: “Dërgohet Projekt-Urdhri Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, ISHTI ka përcjellë paketën ligjore për riorganizimin e strukturës së tij. Duke qenë se, riorganizimi konsiston në ndryshime thelbësore të rishpërndarjes së pozicioneve dhe detyrave të punës për punonjësit, me miratimin e strukturës së re, strukturat përkatëse në ISHTI do të vijojnë nga puna për hartimin e Përshkrimeve të Punës sipas pozicioneve të reja, si dhe do të hartohet Rregullorja e re e Brendshme e institucionit.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit vlerësojmë se ISHTI ka marrë masa për miratimin e strukturës dhe të organikës me dërgimin e shkresës drejtuar MIE. Përsa më sipër grupi i auditimit e konsideron këtë rekomandim në proces.

Rekomandimi është në proces

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISHTI akoma nuk e ka përfunduar procesin e kalimit tek Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, të burimeve njerëzore si dhe dorëzimin e Infrastrukturës TIK ekzistuese nën administrimin dhe inventarin e ISHTI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile, sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

3.1.Rekomandimi: Organet drejtuese në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK si dhe kalimin e aktiveve të sistemeve të informacionit të ISHTI-t tek Agjencia e Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Me anë të shkresës drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me Nr. 820 Prot., datë 19.01.2024, me lëndë: “Dërgohet Projekt-Urdhri Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, ISHTI ka përcjellë paketën ligjore për riorganizimin e strukturës së tij. Duke qenë se, riorganizimi konsiston edhe në kalimin e 1 (një) punonjësi IT në strukturën organizative të AKSHI-t, pas miratimit të strukturës së re, strukturat përkatëse në ISHTI do të vijojnë nga puna për kalimin pranë AKSHI-t edhe të aktiveve të sistemeve të informacionit të ISHTI-t, sipas procedurave përkatëse.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, grupi i auditimit vlerëson se gjendja vazhdon të mbetet e njëjtë me situatën që është konstatuar gjatë periudhës objekt auditimi. Përsa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon dhe mbetet në proces.

Rekomandimi është në proces

4.Gjetje nga auditimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk disponon regjistër risku ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit. Duke mos realizuar identifikimin e risqeve, inspektorati rrezikon që ngjarjet të përsëriten dhe mënyra dhe koha e zgjidhjes së tyre është e papërcaktuar duke rrezikuar mbarëvajtjen e punës. Gjithashtu institucioni nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve, problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën TI.

4.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa për identifikimin dhe analizimin e risqeve për Teknologjinë e Informacionit me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve dhe përmbushjen e objektivave të institucionit. Gjithashtu të marrin masa për hartimin e një plan veprimi për identifikimin, raportimin, trajtimin dhe dokumentimin e incidenteve.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Në zbatim të shkresës së ardhur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 819 Prot., datë 24.01.2024 me

lëndë: “Mbi hartimin e regjistrit të riskut dhe formularit të planit të veprimit për vitin 2024”, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e Riskut të institucionit për vitin 2024 dhe Planin e Masave për minimizimin e riskut, ku janë përfshirë edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit. Gjithashtu, nga Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Sistemeve është hartuar edhe një Regjistër Risku i veçantë, ku trajtohen vetëm risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, ISHTI ka miratuar regjistrin e riskut 2024 dhe planin e masave për minimizimin e riskut hartuar së fundmi, dokumente të cilat nuk i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit gjatë fazës në terren. Përsa më sipër ky rekomandim do të konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi është zbatuar

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ambienti ku është lokalizuar rack-u që përmban infrastrukturën network routerat, swich, etj, nuk përmbush kushtet standarde të përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI.

5.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrin masa për përmirësimin dhe standardizimin e infrastrukturës network me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Me anë të shkresës me Nr. 1917/2 Prot., datë 08.04.2024, me lëndë: “Informacion mbi Rekomandimet e lëna nga KLSH në Projekt-Raport Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, ISHTI ka bërë me dije dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), mbi rekomandimet e lëna nga KLSH në Projektraportin e Auditimit.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sqarojmë se duke qënë se afati për zbatimin e rekomandimit ishte menjëherë dhe në vijimësi si dhe për plotësimin e këtij rekomandimi duhet bashkëpunim i të dy institucioneve, ky rekomandim nuk ndryshon dhe do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

6.Gjetje nga auditimi: Hyrja kryesore në godinën e ISHTI-t është e kontrolluar nga një sistem aksesi për hyrje-daljet e punonjësve të ISHTI-t por sistemi i ngritur përgjithësisht nuk përdoret nga stafi me qëllim monitorimin e lëvizjeve dhe hyrje daljeve, gjë e cila kompromenton nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet fizike të ISHTI-t, duke qënë se në këtë godinë ndodhen dhe laboratorët e ndryshëm për kryerjen e analizave të produkteve dhe nënprodukte të naftës.

6.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrë masa për përdorimin dhe monitorimin e sistemit të aksesit hyrje-dalje nga i gjithë stafi i institucionit me qëllim rritjen e sigurisë në ambientet fizike të ISHTI.

Nga auditimi rezulton se: ISHTI ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe ka marrë masa për zbatimin e tij.

Rekomandimi është zbatuar

7.Gjetje nga auditimi: Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në ISHTI mbështetet në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar, konkretisht:

- Pajisjet Pc kanë parametra minimale specifike dhe përgjithësisht kanë të instaluar sistemin operativ “Windows 7”, sistem për të cilin edhe vetë “Microsoft” që është prodhuesi i tij e ka ndërprere suportin për sistemin dhe nuk e rekomandon përdorimin e tij në vijimësi, duke i bërë pc-të e punonjësve dhe rrjetin netëork të ISHTI-t vulnerabël ndaj sulmeve dashakeqe.
- Pajisjet Pc nuk kanë të instaluar softëare Antivirus;

-Sistemet e operemit apo edhe software-t (si Office) e instaluar nëpër pc janë të pa licencuara;

- Pajisjes periferike si printera janë kryesisht modele të vjetra por edhe të amortizuara, ku në të shumtën e rasteve, vështirë të gjendet bojë, pasi janë me bojra me rezervuar të lëngshëm ose “ink cartridge”.

7.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë të marrë masa për përmirësimin, pajisjen dhe standardizimin e infrastrukturës TIK për punonjësit e administratës së ISHTI, me qëllim krijimin e kushteve optimale për përmbushjen e detyrave gjatë veprimtarisë së punës dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Me anë të shkresës me Nr. 1917/2 Prot., datë 08.04.2024, me lëndë: “Informacion mbi Rekomandimet e lëna nga KLSH në Projekt-Raport Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, ISHTI ka bërë me dije dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), mbi rekomandimet e lëna nga KLSH në Projektraportin e Auditimit.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sqarojmë se duke qënë se afati për zbatimin e rekomandimit ishte menjëherë dhe në vijimësi si dhe për plotësimin e këtij rekomandimi duhet bashkëpunim i të dy institucioneve, ky rekomandim nuk ndryshon dhe do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

8. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit shqyrtoi regjistrat e parashikimeve dhe të realizimeve të prokurimit publik nga i cili rezultoi se vlera e fondit limit në regjistrat e realizimeve në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial nuk rakordojnë me vlerat reale të procedurave të prokurimit. Nga dokumentet shkresore si dhe nga komunikimi verbal me personat përgjegjës në institucion, rezultoi se kjo ka ardhur si pasojë e mos përditësimit të të dhënave ashtu siç parashikohet edhe në dispozitat ligjore në nenin 3 dhe 4 të VKM nr. 285 mbi regjistrin e parashikimeve dhe të realizimeve.

8.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në të ardhmen të marrë masa për rakordimin e të dhënave në sistemin e APP për regjistrat e realizimit në mënyrë që vlerat në regjistrin e realizimeve të jenë vlerat reale të cilat janë përdorur për realizimin e një procedure prokurimi, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga auditimi rezulton se: Në lidhje me rekomandimin, sqarojmë se është rekomanduar mbi zbatimin e dispozitave ligjore përkatësisht nenin 3 dhe 4 të VKM nr.285, ISHTI duhet të kishte marrë masa për të bërë ndryshimet e nevojshme. Përsa më sipër grupi i auditimit e konsideron rekomandimin të pa zbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tre procedurave të prokurimit me vlerë të vogël me objekt:

-“Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”, për vitin 2020;

-“Bojra printeri, fotokopje, tonera”; për vitin 2021

-“Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”, për vitin 2021,

u konstatuan mangësi në:

-firmosjen dhe protokollimin e procesverbalit për përlogaritjen e fondit limit si dhe procesverbalin mbi kalimin tek operatori ekonomik i radhës;

-në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël të sipërpërmendura, asnjë nga anëtarët e komisionit nuk është ekspert i fushës, në kundërshtim me nenin 75/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 parashikon se komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga jo më pak se tre persona, ku të paktën një prej anëtarëve është ekspert i fushës;

-për të treja procedurat e prokurimit nuk është hartuar raporti përmbledhës, në kundërshtim me përcaktimet ligjore në nenin 84 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- për të dyja procedurat e prokurimit me objekt “Shërbim mirëmbajtje për pajisje elektronike”, Autoriteti Kontraktor (ISHTI) dhe Operatori Ekonomik nuk kanë nënshkruar kontratë ndërmjet palëve, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në nenin 15/2 të ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 85 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

9.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe personat e autorizuar mbi hartimin dhe ndjekjen e procedurave të prokurimit, të marrin masa që për çdo procedurë prokurimi që do të zhvillojë në vijimësi të përmbushen përcaktimet e dispozitave ligjore dhe rregullative në fuqi.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ka përmbushur detyrimet për zbatimin e rekomandimit të lënë në lidhje me, marrjen e masave që çdo procedurë prokurimi që do të zhvillojë në vijimësi të përmbushen përcaktimet e dispozitave ligjore dhe rregullative në fuqi.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, ISHTI ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe është marrë angazhimi për ta përmbushur atë, sqarojmë se duke qënë se afati për zbatimin e rekomandimit ishte menjëherë dhe në vijimësi, ky rekomandim nuk ndryshon dhe do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

-Detyra e administratorit të sistemit në rolin e Administratorit të Inspektoratit Shtetëror nuk është e atribuar me anë të shkresës zyrtare nga organet drejtuese të ISHTI-t në mënyrë që të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrat e administratorit të sistemit, duke mos plotësuar kërkesat e përcaktuara në nenin 11, pika 9 të udhëzimit nr. 15 datë 07.05.2015 “Për miratimin e rregullave, Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave, për përdorimin e portalit unik të inspektimit “e-Inspektimi” të Inspektoratit Qendror.

-Nuk disponohet një akt rregullativ i dokumentuar dhe i miratuar për administrimin/menaxhimin e përdoruesve, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve të përdoruesve të ISHTI-it.

10.1.Rekomandimi: Organet drejtuese të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial të marrin masa për përcaktimin e administrator-it të sistemit dhe përgjegjësi dhe të drejtave të tij në rolin e Administratorit të Inspektoratit Shtetëror sipas përcaktimeve rregullatore. Gjithashtu të marrin masa për të hartuar dhe miratuar një akt rregullativ për administrimin/menaxhimin e përdoruesve aktiv dhe jo aktiv të ISHTI, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin e roleve dhe të të drejtave, ndryshimin e fjalëkalimeve të përdoruesve të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial. Të merren në konsideratë praktikrat e përcaktuara në rregulloren për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuar nga AKCESK.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Me anë të shkresës me Nr. 1917/1 Prot., datë 08.04.2024, me lëndë: “Informacion mbi Rekomandimet e lëna nga KLSH në Projekt-Raport Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, ISHTI ka bërë me dije dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), mbi rekomandimet e lëna nga KLSH në Projektraportin e Auditimit.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, ISHTI me anë të shkresës me nr. 5645 prot., datë 28.07.2023, ka përcaktuar administratorin e sistemit, por administratori nuk

ka të drejta për administrimin/menaxhimin e përdoruesve aktiv dhe jo aktiv të ISHTI për shkak se për këtë procedurë i drejtohet AKSHI-t. Përsa më sipër ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin e-inspektimi në momentin e çeljes, sapo logohet përdoruesi (first log-in) me fjalëkalimin fillestar nuk të shfaqet automatikisht tabela e cila të kërkon vendosjen e fjalëkalimit të ri, ruajtjen e tij dhe rilogimin përsëri me anë të fjalëkalimit të ri.

- Sistemi nuk e ka të parametrizuar që pas një periudhe të standardizuar 30 ditore, automatikisht të të kërkojë rigjenerimin e fjalëkalimit.

- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre, bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimit bazuar në pikën 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika b. Të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

- Mbështetur në manualin e përdorimit për burimet njerëzore të sistemit për shtimin e një përdoruesi të ri është e detyrueshme që të vendoset një foto, por nga verifikimi në sistem rezultuan që ka disa përdorues të ISHTI-t që nuk kanë foto.

11.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror (IQ) të marrin masa për të dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre sipas përcaktimeve rregullatore të AKCESK. Gjithashtu të merren masa për adresimin e çështjeve të konstatuar nga grupi i auditimit, me qëllim rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesve.

Nga auditimi rezulton se: ISHTI e ka pranuar rekomandimin dhe pasi ka adresuar problematikat në institucionet përkatëse janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi është zbatuar

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi manualin e përdorimit të aplikacionit “e-inspektimi” u konstatua se:

- Manualin e përdorimit të sistemit nuk janë të miratuar nga asnjë prej organeve drejtuese të IQ apo ASKHI-t, si institucione që kanë në pronësi apo administrojnë sistemin e-inspektimi. Këto manuale janë në versionin e dorëzuar nga OE që ka implementuar sistemin.

- Manualin e sistemit janë hartuar që në vitin 2017, vetëm në versionin fillestar që janë gjeneruar në momentin që është implementuar sistemi dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, përditësim, pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në funksionalitetin e sistemit, ndryshimet strukturore të burimeve njerëzore, etj.

- Manualin e përdorimit të sistemit nuk janë të ndarë sipas funksionaliteteve të inspektorateve, por të njëjtët manuale përdoren për të gjithë inspektoratet, pavarësisht fushës së veprimit që mbulojnë. Rolet dhe përgjegjësitë nuk janë të reflektuar apo përditësuar në manualin e sistemit.

12.1.Rekomandimi: Inspektorati Qendror si institucioni që bashkërendon dhe mbështet veprimtarinë e inspektorateve shtetërore të përditësojë dhe miratojë, manualin e përdorimit të sistemit e-inspektimi duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe kompjuterike të ndodhura në inspektoratet shtetërore.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Me anë të shkresave përkatësisht me Nr. 1917/1 Prot., datë 08.04.2024 dhe Nr. 1917/3 Prot., datë 08.04.2024, me lëndë: “Informacion mbi Rekomandimet e lëna nga KLSH në Projekt-Raport Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, ISHTI ka bërë me dije dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Inspektoratin Qendror (IQ), mbi rekomandimet e lëna nga KLSH në Projektraportin e Auditimit.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sqarojmë se manualët e përditësuar të sistemit e-inspektimi nuk i janë vendosur në dispozicion ISHTI-t nga IQ, ky rekomandim nuk ndryshon dhe do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionalitet e sistemit e-inspektimi u konstatua se: Në modulën e “çështjeve të inspektimit” u konstatua se:

-Në disa raste gjatë zhvillimi të procesit inspektues, përdoruesve u shfaqen problematika mbi gjenerimin e vendndodhjes në tablet;

-Në momentin kur inspektori në çështjen përkatëse e krijon si ri-inspektim ato në sistem dalin të krijuara dy herë;

-Në disa raste është vërejtur se inspektorët, pasi gjenerojnë dokumentet si, Proces Verbalin, Listë Verifikimin dhe Vendimin Përfundimtar, statusi i këtyre çështjeve nuk del “Mbyllur” por vazhdon të jetë në progres;

-Përgjatë vitit 2022 janë hasur raste në versionin ëeb dhe mobile ku sistemi nuk hapej dhe shfaqte error: “Service is unaviable” dhe “HTTP error 503”;

-Në disa raste në versionin ëeb të sistemit e-inspektimi është hasur një error i cili shfaqej: “Lidhje me serverin dështoi”;

- Gjatë procesit të inspektimit është hasur një problematikë nga inspektorët të cilët pasi mbyllin procesin e inspektimit në sistem dhe më pas u duhet të dërgojnë në format elektronik “e-mail” të dhënat përkatëse, u konstatua se ky e-mail nuk shkon në destinacionin e përcaktuar;

-Kur krijohen çështjet në modulën e çështjeve dhe programimit, emri i një subjekti që përsëritet më shumë se 15 herë, nuk mund të regjistrohet në sistem. Për këtë arsye për të futur të gjithë subjektet e programuara në planin vjetor, ato regjistrohen në sistem në modulën e-inspektive/skeduli i çështjeve, me statusin “të programuara”. Praktikisht plani vjetor është në letër por nuk mund të hidhet i gjithi në sistem për shkak të kësaj problematike mbi përsëritjen e të njëjtit nipt. Kjo gjë krijon probleme pasi ka kompani të cilat kanë më shumë se një degë në të gjithë vendin por kanë një nipt të vetëm. Pra praktikisht këto subjekte nuk mund të inspektohen më shumë se 15 herë për shkak të pengesës së trajtuar më lart në sistem, edhe pse kanë më shumë degë në të gjithë vendin;

-Tek moduli i çështjeve të inspektimit nuk shfaqen të gjitha ri inspektimet dhe kur kërkohet me arsyen ri inspektim.

Në modulën “krijo çështje” u konstatua se:

-Në fazën e një procesi inspektimi jashtë planit vjetor dhe mujor, mungon mundësia e zgjedhjes së një arsyeje tjetër përveç atyre të paracaktuara në sistem. Mundësia e shtimit të arsyeve ose argumenteve sipas argumenteve specifike që inspektori e gjykon sipas situatës që konstaton, do të lehtësonte procesin e inspektimit në fazë;

-Në modulën e çështjeve të inspektimit tek fusha “inspektori”, përdoruesi nuk ka një opsion zgjedhjeje për të shkruar ose për të kërkuar (search) emrin e plotë të inspektorit që do të shtojë ose përzgjedhë;

-Përditësimi i degëve të subjektit nuk realizohet automatikisht tek fusha bizneset pa bërë search manual tek fusha bizneset.

Në modulën e “programimit” u konstatua se:

-Inspektorët e larguar duhet të jenë jo aktiv të paselektueshëm kur krijojnë çështje “Tek përcaktimi i programeve mujore”;

Në modulën e “skeduli i çështjeve” u konstatua se:

Sistemi nuk të ofron mundësi që të zgjedhësh një arsye tjetër përveç asaj të paracaktuarës dhe nuk ke mundësi të upload-osh dokumentin justifikues që citohet në përshkrimin e anulimit. Kjo gjë ndikon negativisht, në ndërprerjen e gjurmës së auditimit, pasi për të parë të gjithë procesin në sistem se pse është anuluar një çështje, do të duhet ta lexosh numrin e shkresës së hedhur manualisht në sistem dhe pastaj të shkosh në zyrën e protokoll arkivës për të marrë dokumentin justifikues me argumentet përkatëse.

Mbi shtyrjen e një procesi inspektues

Në rastet kur një proces inspektimi shtyhet për një arsye të caktuar dhe procesi i inspektimit nuk realizohet në periudhën e përcaktuar në autorizimin e parë të Kryeinspektorit, atëherë procesi duhet të rivijojë me një autorizim të ri që shtyhet në periudhën për javën pasardhëse. Nga auditimi u konstatua se sistemi e-inspektime nuk ka element kontrolli mbi këtë fazë dhe i lejon inspektorët që të procedojnë në sistem me procesin e inspektimit me plotësimin e hapave të mëtejshëm edhe pse nuk është hedhur akoma autorizimi i ri në sistem që duhet aprovuar nga Kryeinspektori. Në këto raste autorizimi i ri miratohet pasi ka mbaruar i gjithë procesi i inspektimit dhe është dhënë dhe vendimi përfundimtar.

Pra sistemi nuk ia ndërpret procesin inspektorit që të vazhdojë në hallkat e tjera por ja lejon atij të vazhdojë të kryejë procesin inspektues pa u miratuar akoma autorizimi i ri nga Kryeinspektori.

13.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi dhe të ofrojnë zgjidhje për to me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të sistemit e-inspektimi, si dhe të merren masa për shtimin e funksionaliteteve të reja në sistemin e-inspektimi sipas nevojës së përdoruesve në sistem.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Me anë të shkresave përkatësisht me Nr. 1917/1 Prot., datë 08.04.2024 dhe Nr. 1917/3 Prot., datë 08.04.2024, me lëndë: “Informacion mbi Rekomandimet e lëna nga KLSH në Projekt-Raport Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, ISHTI ka bërë me dije dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Inspektoratin Qendror (IQ), mbi rekomandimet e lëna nga KLSH në Projektraportin e Auditimit.

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sqarojmë se jo të gjitha funksionalitetet janë shtuar në sistem dhe për plotësimin e këtij rekomandimi duhet bashkëpunim i të dy institucioneve. Përsa më sipër ky rekomandim nuk ndryshon dhe do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

-Versioni mobile i sistemit e-inspektimi vazhdimisht punon me ndërprerje dhe ka probleme me ecurinë normale të punës duke ndikuar negativisht në veprimtarinë e punës së inspektorëve. Ky version ka nevojë për përditësime dhe upgrade;

-Në faqen e parë të versionit mobile pasi inspektori logohet, i shfaqen të gjitha çështjet e hapura për të gjithë muajin, pra në qoftë se inspektorit do ti nevojitet të shohë një çështje të tijën, i duhet të bëjë search për ta gjetur;

-Gjatë krijimit të një çështje në sistem, inspektori i cili po krijon çështjen për të shtuar inspektorin e dytë në çështje, i duhet të bëjë scroll të gjithë listën e emrave të inspektorëve pasi sistemi nuk ta ofron mundësinë të bësh search në këtë fushë;

-Tek fusha “Aktiviteti ILO” që zgjedh inspektori, gjatë krijimi të një çështjeje, nuk i shfaqet mundësia për të zgjedhur një lloj tjetër subjekti që ka p.sh bombula ose pajisja nën presion përveç formës GLN (Gaz i lëngshëm). Pra sistemi të ofron të zgjedhës vetëm këtë mundësi GLN pavarësisht se subjekti që do të inspektohet nuk ka këtë lloj bombule, inspektori është i detyruar ta zgjedhë këtë mundësi pasi nuk ka opsion tjetër;

-Sistemi nuk e ndalon të procedohet një çështje të cilës i është përcaktuar afati i fillimit dhe mbarimit. Pra në qoftë se një çështje ka të përcaktuar në autorizimin përkatës afatin e fillimit dhe mbarimit të saj, një inspektor mund të punojë në këtë çështje edhe pasi të ketë kaluar afati i përfundimit të përcaktuar në autorizim. Pra çështja nuk mbyllet kur është e përcaktuar në sistem në autorizim por në të mund të punohet deri kur ta mbyllë inspektori;

-Tek Lista e verifikimit të subjekteve që plotësohet nga inspektorët në terren, në rast se inspektorët verifikojnë që një subjekt ka një pajisje nën presion për të cilën nuk disponon dokumentacionin e nevojshëm atëherë inspektorit nuk i shfaqet një mundësi që të zgjedhë shënimin, që subjekti i inspektuar ti lihet afat për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen nën presion, pa qenë nevoja për plotësimin e të gjithë listës së verifikimit;

-Përgjatë vitit 2022 janë hasur raste në versionin mobile në tabletë ku pasi inspektorët logohen nuk ju dalin çështjet e tyre në progres edhe kur në sistem janë të hapura;

-Ka raste që sistemi nuk merr vendndodhjen e saktë në zona të caktuara kur nuk ka sinjal të mirë. Në këto raste inspektorëve ju duhet ta ruajnë çështjen në mënyrë që ta sinkronizojnë në një moment të dytë kur të kenë sinjal interneti;

-Inspektorët duhet të përdorin internetin e tyre ose të subjektit që po inspektojnë për të ngarkuar dhe sinkronizuar çështjen me të cilën po punojnë, pasi pajisjet tablet nuk kanë internet për ta kryer këtë proces.

14.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror të analizojë dhe adresojë tek ofruesi i shërbimit të mirëmbajtjes parregullsitë, mangësitë e konstatuara nga auditimi në aplikacionin mobile të sistemit e-inspektimi. Të përditësojnë aplikacionin mobile dhe të ofrojnë zgjidhje për mangësitë e konstatuara me qëllim përmirësimin e performancës së funksionimit të aplikacionit e-inspektimi, si dhe të merren masa për sigurimin e internetit në pajisjet tablet të inspektorëve të ISHTI në mënyrë që inspektorët të ushtrojnë veprimtarinë e tyre inspektuese në terren pandërprerje.

Përgjigja e subjektit me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024: Me anë të shkresës me Nr. 1917/1 Prot., datë 08.04.2024, me lëndë: “Informacion mbi Rekomandimet e lëna nga KLSH në Projekt-Raport Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, ISHTI ka bërë me dije dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Nga auditimi rezulton se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sqarojmë se për zbatimin e këtij rekomandimi duhet bashkëpunim ndërmjet institucioneve për zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë procesit të punës. Përsa më sipër ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Akt Verifikimi nr. 2, datë 29.02.2024 protokolluar në ISHTI me nr. 3265, datë 29.02.2024, si dhe është trajtuar në faqet 3-17 të Projekt Raportit të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara 6-mujorin e parë të vitit 2023” mbi të cilin janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit. Nga ISHTI janë paraqitur komente/ observacione me shkresën nr. 4424/1, datë 22.04.2024, mbi sa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit duke reflektuar ndryshimet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Përmbledhëse e Masave

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa Organizative	14	14	3	-	10	1

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes ISHTI-it i janë rekomanduar 14 masa organizative. Nga auditimi rezultoi se, nga masat organizative janë zbatuar 3 masa organizative, janë në proces zbatimi 10 masa organizative dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative. Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit që rezultoi i pazbatuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi 1: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 1189/6 prot, datë 09.05.2023 drejtuar ISHTI, **nuk është zbatuar rekomandimi (8.1), si vijon:**

8.1.Rekomandimi: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial në të ardhmen të marrë masa për rakordimin e të dhënave në sistemin e APP për regjistrat e realizimit në mënyrë që vlerat në regjistrin e realizimeve të jenë vlerat reale të cilat janë përdorur për realizimin e një procedure prokurimi, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Rekomandimi 1: Strukturat përkatëse të ISHTI, të marrin masat e nevojshme për rekomandimin që nuk është zbatuar me qëllim zbatimin e tij.

Brenda 3 muajve të II të vitit 2024 dhe në vijimësi

Të tjera

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2024, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e radhës që KLSH do kryejë në këto subjekte.

Për rekomandimin i cili ka rezultuar i pazbatuara nga auditimi i ushtruar “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, së bashku me pjesë nga Raporti Përfundimtar, do të përcillen në subjekt sipas Vendimit të Kryetarit për këtë auditim.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2023”

Tiranë Maj 2024

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.	Hyrje	3
	1. Objekti i auditimit	4
	2. Qëllimi i auditimit	4
	3. Metodologjia e auditimit	4
	4. Konkluzione	5
	5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5
III.	Zbatimi i Rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	5
	1. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit të auditimit	5
	2. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes	5
	3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit	6
	4. Realizimi i rekomandimeve	6-12
IV.	Konkluzione dhe Rekomandime	12-13

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SH.A, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Instituti i Sigurimeve dhe Rrjeti Akademik Shqiptar”, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si: vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisione disiplinore për dhënien e masave disiplinore.
- Hartimin e programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjor për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.154/205 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për Shpërblim dëmi ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.

Kuadri ligjor dhe nënligjor i verifikimit të zbatimit rekomandimeve:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC
- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Manualët e Auditimit, Rregulloret, Udhëzimet e KLSH-së.

II. HYRJE

Auditimi u krye në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2, e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Programit të Auditimit nr. 223/4 prot., datë 08.02.2024 me

objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për marrjen e masave organizative, dhe të masave të tjera, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH-ja për misionet e mëparshme realizuar në subjektet UKT, ISHTI, ISSH dhe RASH.

Auditimi është kryer nga:

1. K.S, përgjegjës grupi
2. M.P, anëtare
3. A.K, anëtare
4. A.A, anëtar
5. D.B, anëtar

Çështjet e Audituaras:

1. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (germa “j” e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”).

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014).

2. Realizimi i rekomandimeve për *ndryshime apo përmirësime në legjislacionin* në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

3. Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

II.1. Objekti i auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (terren) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, etj.

II.2. Qëllimi i auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë

e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

II.4. Konkluzione

Në përfundim të procesit të punës audituese në terren nga subjekti i audituar nuk u paraqiten kundërshti mbi aktverifikimin e mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.

Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 17 masa organizative. Janë zbatuar 5 masa organizative, janë në proces zbatimi 7 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 3 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative.

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Pavarësisht nga puna e bërë, niveli i realizimit të rekomandimeve është 29%, për disa nga masat për të cilat janë në proces zbatimi ose janë zbatuar pjesërisht duhet më shumë punë për realizimin e tyre në nivelin 100% të rekomandimeve.

III. Zbatimi i Rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

III.1. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

I. Instituti i Sigurimeve Shoqërore - ISSH

Nga KLSH, me shkresën nr. 1188/5 prot, datë 18.05.2023 për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 17 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 17 masa organizative. Janë zbatuar 5 masa organizative, janë në proces zbatimi 7 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 3 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative.

III.2 Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 1188/5 prot, datë 18.05.2023, është dërguar “Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Institutin e Sigurimeve Shoqërore”. ISSH ka kthyer përgjigje për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve më datë 20.06.2023, me shkresën nr. 01/4 prot, duke respektuar afatin prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”

III.3 Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 1188/5 prot, datë 18.05.2023, është dërguar “Raporti

Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Institutin e Sigurimeve Shoqërore”. ISSH nuk ka kthyer përgjigje brenda afateve për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH brenda 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit.

III.4 Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

Nga të pranuarat	Nr.	%
Zbatuar	5	29
Zbatuar pjesërisht	3	18
Në proces	7	41
Nuk janë zbatuar	2	12

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse në auditimin e mëparshëm për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej 17 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 17 masa ose 100% masa organizative. Janë zbatuar plotësisht 5 masa ose 29% masa organizative, janë në proces zbatimi 7 ose 41% masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 3 masa ose 18% masa organizative dhe janë pa zbatuar 2 masa ose 12% masa organizative.

Më hollësisht, auditimi i zbatimit të rekomandimeve:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

ISSH nuk ka një strategji institucionale, përfshirë atë për Teknologjinë e Informacionit, duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme, si dhe instrumentat e nevojshme për matjen e objektivave. Mungesa e një plani strategjik mbart riskun e keqadresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së ISSH.

1.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik Institucional, përfshirë planifikimin strategjik mbi teknologjinë e informacionit ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në ISSH.

Nga auditimi rezulton se: ISSH nuk ka hartuar një plan strategjik institucional, por një “Plan strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Institutin e Sigurimeve Shoqërore për periudhën 2024-2026”. Megjithëse ky plan përmban disa drejtime strategjike të ISSH, duke përfshirë dhe elemente nga IT si “zhvillimi i sistemeve të IT për të forcuar kontrollin dhe administrimin e fushave me risk të lartë” dhe “vlerësimi dhe auditimi i sistemeve të IT”, është larg të qenit një plan strategjik institucional i mirëfilltë (strategji institucionale).

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në strukturën e IT në Drejtorinë e Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) ka 60 vende pune, nga të cilat rezulton se ka 3 vende vakante të cilat nuk janë plotësuar ende. Këto vakanca kanë ardhur si pasojë e largimit të punonjësve IT.

2.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në ISSH, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e vendeve vakante sipas strukturës organike të tyre.

Nga auditimi rezulton se: Me Vendimin nr. 13, datë 28.12.2023, është miratuar struktura e re organizative dhe është autorizuar Drejtori i Përgjithshëm i ISSH të përcaktojë strukturat analitike brenda datës 31.03.2024.

Rekomandimi është në proces

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISSH nuk ka patur plan trajnimi vjetor për burimet njerëzore të Drejtorisë së Burimeve të Informacionit, në lidhje me Teknologjinë e Informacionit. Gjatë vitit 2022, janë zhvilluar 4 trajnime në lidhje me problematikat e dala gjatë funksionimit të aplikimeve online dhe të sistemeve PCAMS, DAMIS dhe CMIS, por nuk ka patur propozime nga niveli menaxherial i ISSH për zhvillimin e trajnimeve mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. ISSH nuk ka zhvilluar trajnime të mjaftueshme për zhvillimin profesional të punonjësve.

3.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në ISSH të marrin masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit IT dhe të çdo përdoruesi të sistemeve TIK në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit, si dhe të hartojnë e miratojnë plane vjetore trajnimi.

Nga auditimi rezulton se: ISSH është në fazë ristrukturimi ku për pasojë është afektuar dhe organika e Drejtorisë së IT.

Rekomandimi është në proces

4.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dhomës së serverëve në ISSH u konstatua se një Rack (raft me pajisje kompjuterike) nuk ishte pronë e ISSH, por e AKSHIT i cili ruhej në dhomën e serverëve të ISSH. Për këto pajisje nga ISSH nuk disponohej asnjë dokumentacion justifikues për transferimin si dhe qëllimin e vendosjes së tyre në ambientet e dhomës së serverëve të ISSH. Vendosja e këtyre e pajisjeve kompjuterike mund të sjelli komprometimin e të dhënave duke qenë një institucion i rëndësisë së veçantë, ku në mjediset e tij mban sisteme dhe pajisje kompjuterike të cilat ruajnë dhe përpunojnë të dhëna sensitive.

4.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa të menjëhershme për hartimin e dokumentacionit përkatës, ku të argumentohet arsyeja e vendosjes së pajisjeve kompjuterike (jo të institucionit) në dhomën e serverëve dhe personat e autorizuar që kanë akses në to.

Nga auditimi rezulton se: ISSH ka argumentuar arsyen e vendosjes së rack-ut në dhomën e serverave të ISSH, duke bashkëlidhur dokumentacionin përkatës.

Rekomandimi është zbatuar

5.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren në Drejtorinë rajonale të ISSH Vlorë, grupi i auditimit konstatoi se infrastruktura netëork e pajisjeve ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave është në kushtet jo optimale, ku shërbimet e ngritura mbi këto rrjete nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës.

-Nuk ka një linjë back up interneti në rast të shpërthimit të linjës, duke sjellë kështu mosfunksionim të sistemit dhe ndërprerje të ofrimit të shërbimeve.

-Kompjuterat nuk janë të pajisur me antivirus për mbrojtje ndaj sulmeve.

-Nuk ka një server qendror të pajisur me Active Directory Domain Controller për menaxhimin e përdoruesve dhe vendosjen e politikave të sigurisë.

-Nuk kanë një pajisje firewall për mbrojtjen e rrjetit nga sulmet e jashtme.

5.1.Rekomandimi: ISSH të marrë masa për pajisjen dhe standardizimin e infrastrukturës IT në Drejtorinë Rajonale si dhe të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një procedure standarde për komunikimin dhe zgjidhjen e problematikave që lindin me Drejtorinë Vendore në lidhje me sistemet IT, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

Nga auditimi rezulton se: ISSH është në proces të marrjes së masave për optimizimin e infrastrukturës network dhe rritjen e sigurisë në rrjet në drejtoritë rajonale.

Rekomandimi është në proces

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISSH nuk disponon një infrastrukturë BCC (Business Continuity Center), si dhe nuk ka një plan mbi vazhdimësinë e punës dhe rimëkëmbjet nga katastrofat në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

Backup-et e sistemeve PCAMS, CMIS dhe DMAIS janë të ruajtura në Tape library, të cilat pasi mbushen ruhen në të njëjtën godinë me sistemet PCAMS, CMIS dhe DMAIS.

-Kopjet (backup) e të dhënave nuk testohen rregullisht

6.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në bashkëpunim me AKSHI-n, bazuar në rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për ndërtimin e një qendre *Business Continuity*.

Nga auditimi rezulton se: ISSH ka mundur krijimin e një qendre të *Business Continuity*.

Rekomandimi është zbatuar

6.2.Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve të Informacionit të marrë masa për kryerjen dhe testimin periodik të backup-it të të dhënave të sistemeve duke e dokumentuar procesin.

Nga auditimi rezulton se: ISSH ka parashikuar procedurat për kryerjen dhe testimin periodik të backup-it të të dhënave të sistemeve duke dokumentuar procesin.

Rekomandimi është në proces

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i faqes web konstatua se:

Tek menuja “Programi i Transparencës”:

Seksioni “Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve” nuk është publikuar viti 2022;

Seksioni “Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve” nuk përmban asnjë informacion;

Seksioni “Mekanizmat kontrollues dhe monitorues” nuk përmban asnjë informacion.

7.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa për përditësimin dhe përmirësimin e faqes web (me informacione, rregullore, akte, etj.), si dhe reflektimin e mangësive të dala nga auditimi, me qëllim rritjen e transparencës dhe ndihmesën ndaj qytetarëve.

Nga auditimi rezulton se: ISSH ka përditësuar seksionin “Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve” dhe “Mekanizmat kontrollues dhe monitorues”. Seksioni “Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve” nuk përmban ende të dhëna/link-e mbi rubrikat specifike.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratës së zbatimit me objekt “Marrëveshje shërbimi për sistemet informatike të DMAIS për menaxhimin dhe arkivimin e dokumenteve, PCAMS për llogaritjen dhe caktimin e pensioneve, FMS për menaxhimin financiar, CMIS për menaxhimin e deklarimit online të kontribuesve, rrjetit informatik dhe pajisje të caktuara të dhomës së serverave, pajisje IT për ISSH dhe komunikim ISSH-Arkiva (ISSH-Drejtori në varësi)” u konstatua se:

Sistemet që ka në përdorim ISSH (PCAMS, FMS, DMAIS, CMIS) janë të papërditësuara dhe nuk ka patur asnjë kërkesë nga ana e ISSH për përditësimin e tyre, mundësi kjo e parashikuar nga pika 10.5 e Kushteve të veçanta të kontratës midis AK dhe Kontraktuesit. Përditësimet e sistemeve kanë qenë të nevojshme për mirëfunksionimin e tyre dhe ISSH nuk i ka dërguar asnjë kërkesë Kontraktuesit bazuar në pikën e mësipërme të Kontratës.

8.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrin masa që në kontratat e mirëmbajtjes së sistemeve të ISSH që do të lidhen në vazhdimësi të sanksionohet që Kontraktuesi duhet të kryejë rregullisht përditësim të këtyre sistemeve.

Nga auditimi rezulton se: Në marrëveshjen e re nr. 42 prot., datë 21.12.2022, të lidhur midis AKSHI-t dhe Operatorit Ekonomik, me objekt “Përmirësimi i sistemit të ISSH- së dhe infrastrukturës fizike- për ISSH” është parashikuar dhe përditësimi i sistemeve.

Rekomandimi është zbatuar

8.2.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të verifikojë rregullisht nëse sistemet PCAMS, DMAIS, FMS, CMIS kanë nevojë për përditësime, ndërhyrje apo korrigjime duke i bërë kërkesën përkatëse Kontraktuesit.

Nga auditimi rezulton se: ISSH i ka kërkuar Kontraktuesit disa ndryshime në sisteme me qëllim përditësimin e sistemeve PCAMS, DMAIS, FMS, CMIS.

Rekomandimi është zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në databazën e PCAMS në tablespace Audit_Aux nuk ka hapësira të nevojshme të alokuara në memorie (HDD); kjo mungesë e hapësirës (në tablespace) ka sjellë ulje të performancës dhe gabime në databazë.

-Nga auditimi i sistemit DMAIS në lidhje me performancën e veprimeve, duke u bazuar në treguesit si: Koha e përgjigjes, koha e përpunimit, përdorimi i burimeve të sistemit, u konstatua se DMAIS i përgjigjet me vonesë kërkesave të përdoruesve.

9.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa që në vijim të kryejë sistemimet e nevojshme në databazën e sistemeve duke u bazuar në problematikat e shfaqura vazhdimisht nga njoftimet për gabime të ndodhura në sistem.

Nga auditimi rezulton se: ISSH është në procesin e kryerjes së sistemimeve të nevojshme në databazën e sistemeve, për të shmangur problematikat e hasura gjatë auditimit.

Rekomandimi është në proces

10.1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për sistemet CMIS dhe DMAIS nuk ka një ambient test për menaxhimin e ndryshimeve që të sigurojë që çdo ndryshim i bërë në sistemin të mos ndikojë negativisht në performancën e përgjithshme të sistemit. Mungesa e një ambient testi do të thotë që nuk ka mënyra për të verifikuar nëse ndryshimet e bëra në sistem funksionojnë.

10.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa për zhvillimin e një ambienti test në servera për aplikimin e ndryshimeve përpara se ato të kalojnë në live si dhe hartimin e një akti rregullator për përcaktimin e hapave konkret për menaxhimin e ndryshimeve në sisteme (kush i inicion, autorizon, zbaton, etj.).

Nga auditimi rezulton se: ISSH, megjithëse ka parashikuar ambjentet test për të gjitha sistemet pas upgrade-t, nuk i ka realizuar ende.

Rekomandimi nuk është zbatuar

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se infrastruktura e përdorur për operimin e sistemeve (PCAMS, CMIS, DMAIS) si: (Red Hat Enterprise Linux (RHEL) 5, Windows server 8, Databaza në Oracle 11g, Cisco asa5520-bun), është në statusin end of life (ka arritur fundin e jetës), që do të thotë se prodhuesi i këtyre pajisjeve dhe softeve nuk ofron më asistencë teknike, përditësime të sigurisë ose rregullim të gabimeve për këto versione, duke ndikuar në plotësimin e nevojave aktuale si dhe rritjen e kapaciteteve në të ardhmen.

11.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrin masa për përditësimin dhe standardizimin e infrastrukturës IT, si dhe të monitorojnë sistemet që nuk përditësohen më për çdo tregues të mundshëm të shkeljeve të sigurisë ose

dështimeve të sistemit.

Nga auditimi rezulton se: Në kontratën nr. 42 prot., datë 21.12.2022, të lidhur midis AKSHI-t dhe Operatorit Ekonomik, me objekt “Përmirësimi i sistemit të ISSH- së dhe infrastrukturës fizike- për ISSH”, është parashikuar dhe përditësimi dhe standardizimi i infrastrukturës IT.

Rekomandimi është zbatuar

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sistemet (CMIS, DMAIS, PCAMS) nuk ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Mungesa e ndërveprimit ndërmjet sistemeve rezulton në çështje të shumta, duke përfshirë: Mospërputhje e të dhënave, procese që konsumojnë kohë, rreziqe të sigurisë. Çdo sistem menaxhohet veçmas, duke çuar në rreziqe të mundshme sigurie për shkak të kontrolleve të ndryshme të aksesit, mekanizmave të vërtetimit dhe dobësive në secilin sistem. Pamundësia për të ndarë të dhënat ndërmjet sistemeve nënkupton që subjekti humb mundësitë për të fituar njohuri mbi operacionet e tyre, për të optimizuar proceset dhe për të marrë vendime të bazuara në të dhëna.

12.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa për të vendosur në funksionim të plotë ndërveprimin ndërmjet sistemeve që ISSH disponon me qëllim rritjen e efikasitetit për mirëmenaxhimin e skemës së pensioneve, si dhe për të llogaritur përfitimet, menaxhuar kontributet, digjitalizuar dokumentet dhe çdo aspekt tjetër që lidhet me veprimtarinë e institucionit.

Nga auditimi rezulton se: ISSH është në procesin e vënies në funksionim të plotë ndërveprimin ndërmjet sistemeve që disponon, parashikuar në upgrade.

Rekomandimi është në proces

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Sistemit elektronik për menaxhimin e kontributeve (CMIS), sistem i cili komunikon nëpërmjet ëbservice-ve me Sistemin e Tatimeve, u konstatuan problematika si:

- Raste të vendosjes gabim të Numrit Personal NID, të cilat kanë sjellë një problem në sistemin CMIS, si dhe nuk shfaqen akoma listëpagesat e periudhave të personave gjyqfitues.
- Në sistemin CMIS nuk shfaqen muaj të veçantë për subjekte të ndryshme dhe individë të ndryshëm, në vite të ndryshme, periudha të cilat ndërkohë shfaqen në sistemin tatimor.
- Në rastet kur subjektet kryejnë pagesa pjesore dhe për punëmarrës të veçantë, të dhënat e kontributeve të paguara nuk shfaqen në sistemin CMIS.
- Në rastet kur subjektet kryejnë korrigjimin e deklaratës tatimore listëpagesat ESIG-25, krijon probleme të mundshme sidomos lidhur me kushtet e përfitimeve afatshkurtra, pasi subjektet “luajnë” me deklaratimet e punonjësve (për shembull një punonjës merr përfitimin nga ISSH, më pas bëhet rivlerësim i listëpagesës duke ndryshuar pagën ose duke e hequr fare punonjësin nga listëpagesa).
- Janë evidentuar raste të sjelljes në listëpagesa të personave që kanë ndërruar jetë.
- Në shumë raste, sidomos tek pagat minimale njëra nga pagat, vlera e pagës bruto (gross_salary) ose pagës kontributive (gross_salary_contib) vjen me vlerën “0” (zero lekë). Në disa listëpagesa, vlera e pagës bruto (gross_salary) ose pagës kontributive (gross_salary_contib) vjen nën pagën minimale edhe pse numri i ditëve të punuara është 22 ose 26.
- Evidentohen raste të vendosjes gabim të Numrit Personal NID.

13.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masa të nevojshme që të optimizojnë sistemet elektronike që shfrytëzohen nga të dyja palët, me qëllim shkëmbimin e saktë të të dhënave midis tyre.

Nga auditimi rezulton se: ISSH, me anë të shkresës nr. 658 prot., datë 18.01.2024, ka informuar DPT mbi problematikat e sipërpërmendura dhe ka kërkuar zgjidhjen e tyre me qëllim optimizimin e sistemeve elektronike në shërbim të të gjithë kontributpaguesve.

Rekomandimi është në proces

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përdoruesve të sistemeve PCAMS (Sistemi elektronik i kalkulimit dhe pagesës së përfitimeve), CMIS (Sistemi elektronik për menaxhimin e kontributeve) DMAIS (Sistemi elektronik për digjitalizimin e dokumenteve të Arkivit Qendror) u konstatua se nuk ka të dhëna se cilat janë personat e autorizuar që ushtrojnë rolin e administratorit të sistemeve (CMIS, ADMIN, DMAIS, DATALOD PCAMS).

Fjalëkalimi në sistemet (PCAMS, CMIS, DMAIS) nuk është i parametrizuar për nga kompleksiteti dhe gjatësia e tij. Për kriteret e fjalëkalimit të përdoruesve fundor nuk janë hartuar apo implementuar standarde me qëllim forcimin e tij.

14.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores për krijimin dhe administrimin e përdoruesve të brendshëm, ku të jenë të pasqyruara saktë të drejtat dhe detyrimet për të gjithë përdoruesit

Gjithashtu, ISSH të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave mbi fjalëkalimin e përdoruesve në sistemet (PCAMS, CMIS, DMAIS) ku të përcaktohet kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij.

Nga auditimi rezulton se: ISSH, megjithëse ka zgjidhur problematikat me fjalëkalimet, nuk ka hartuar dhe miratuar ende një rregullore për krijimin dhe administrimin e përdoruesve të brendshëm.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ISSH nuk ka hartuar akte rregullatore për menaxhimin e log-eve digjitale ku specifikohen kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë, në kundërshtim me pikën 4 shkronja a) të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike”, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

15.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrin masa për rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke hartuar një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim uljen e riskut mbi sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen dhe tjetërsimin e tyre. Gjithashtu, në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element tjetër që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

Nga auditimi rezulton se: ISSH nuk ka marrë ende masa për hartimin e një procedure/rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit.

Rekomandimi nuk është zbatuar

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Akt Verifikimi nr. 3, datë 01.03.2024 protokolluar në ISSH me nr. 1452/2 prot datë 01.03.2024, si dhe është trajtuar në faqet 3-14 të Projekt Raportit të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara 6-mujorin e parë të vitit 2023” mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit.

Përmbledhëse e Masave

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa Organizative	17	17	5	3	7	2

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes ISSH-ës i janë rekomanduar 17 masa organizative. Nga auditimi rezultoi se, nga masat organizative janë zbatuar 5 masa organizative, janë në proces zbatimi 7 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 3 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative. Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht dhe të pazbatuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 1188/5 prot, datë 18.05.2023 drejtuar ISSH, **janë zbatuar pjesërisht rekomandimet (1.1, 7.1, 14.1), si vijon:**

1.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik Institucional, përfshirë planifikimin strategjik mbi teknologjinë e informacionit ku të adresohen qartë objektivat e institucionit duke reflektuar ndryshimet institucionale, strukturore dhe ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), të ndodhura ndër vite në ISSH.

7.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa për përditësimin dhe përmirësimin e faqes web (me informacione, rregullore, akte, etj.), si dhe reflektimin e mangësive të dala nga auditimi, me qëllim rritjen e transparencës dhe ndihmesën ndaj qytetarëve.

14.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullores për krijimin dhe administrimin e përdoruesve të brendshëm, ku të jenë të pasqyruara saktë të drejtat dhe detyrimet për të gjithë përdoruesit. Gjithashtu, ISSH të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave mbi fjalëkalimin e përdoruesve në sistemet (PCAMS, CMIS, DMAIS) ku të përcaktohet kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij.

1.1.Rekomandimi: Strukturat përkatëse të ISSH, të marrin masat e nevojshme për rekomandimet e zbatuara pjesërisht me qëllim përsheptimin e procesit për zbatimin e plotë të tyre.

Brenda 3-mujorit të II të vitit 2024 dhe në vijimësi

2.1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 1188/5 prot, datë 18.05.2023 drejtuar ISSH, **nuk janë zbatuar rekomandimet (10.1, 15.1), si vijon:**

10.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa për zhvillimin e një ambienti test në servera për aplikimin e ndryshimeve përpara se ato të kalojnë në live si dhe hartimin e një akti rregullator për përcaktimin e hapave konkret për menaxhimin e ndryshimeve në sisteme (kush i inicion, autorizon, zbaton, etj.).

15.1.Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në bashkëpunim me Agjencinë

Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrin masa për rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke hartuar një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim uljen e riskut mbi sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen dhe tjetërsimin e tyre. Gjithashtu, në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element tjetër që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

2.1.Rekomandimi: Strukturat përkatëse të ISSH, të marrin masat e nevojshme për rekomandimet që nuk janë zbatuar me qëllim përsheptimin për zbatimin e tyre.

Brenda 3 muhorit të II të vitit 2024 dhe në vijimësi

Të tjera

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2024, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e radhës që KLSH do kryejë në këto subjekte.

Për rekomandimet të cilat kanë rezultuar të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht nga auditimi i ushtruar “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, së bashku me pjesë nga Raporti Përfundimtar, do të përcillen në subjekt sipas Vendimit të Kryetarit për këtë auditim.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Shoqërinë Ujësjetllës
Kanalizime Tiranë SH.A”**

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
MËPARSHME TË EVADUARA NË 6-MUJORIN E PARË TË VITIT 2023”**

Tiranë Maj 2024

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.	Hyrje	3
	1. Objekti i auditimit	4
	2. Qëllimi i auditimit	4
	3. Metodologjia e auditimit	4
	4. Konkluzione	5
	5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	5
III.	Zbatimi i Rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	5
	1. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimit të auditimit	5
	2. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes	5
	3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit	5
	4. Realizimi i rekomandimeve	6-12
IV.	Konkluzione dhe Rekomandime	12-13

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim në Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SH.A, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Instituti i Sigurimeve dhe Rrjeti Akademik Shqiptar”, “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023;
- Hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si: vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisione disiplinore për dhënien e masave disiplinore.
- Hartimin e programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjor për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.154/205 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për Shpërblim dëmi ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.
- Zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore dhe administrative. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimeve nuk janë zbatuar.

Kuadri ligjor dhe nënligjor i verifikimit të zbatimit rekomandimeve:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të IFAC
- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Manualët e Auditimit, Rregulloret, Udhëzimet e KLSH-së.

II. HYRJE

Auditimi u krye në zbatim të nenin 15 shkronja (j) dhe pika 2, e nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Programit të Auditimit nr. 223/4 prot., datë 08.02.2024 me

objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023”, u krye auditimi mbi hartimin e plan veprimit dhe raportimit në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për marrjen e masave organizative, dhe të masave të tjera, të rekomanduara në përfundimet e auditimit nga KLSH-ja për misionet e mëparshme realizuar në subjektet UKT, ISHTI, ISSH dhe RASH.

Auditimi është kryer nga:

1. K.S, përgjegjës grupi
2. M.P, anëtare
3. A.K, anëtare
4. A.A, anëtar
5. D.B, anëtar

Çështjet e Audituaras:

1. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (germa “j” e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”).

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit përfundimtar të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014).

2. Realizimi i rekomandimeve për *ndryshime apo përmirësime në legjislacionin* në fuqi, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë, të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

3. Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

II.1. Objekti i auditimit

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (terren) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, etj.

II.2. Qëllimi i auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë

e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

II.4. Konkluzione

Në përfundim të procesit të punës audituese në terren nga subjekti i audituar nuk u paraqiten kundërshti mbi aktverifikimin e mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja.

Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 15 masa organizative. Janë zbatuar 5 masa organizative, janë në proces zbatimi 7 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative.

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Pavarësisht nga puna e bërë, niveli i realizimit të rekomandimeve është 33%, për disa nga masat për të cilat janë në proces zbatimi ose janë zbatuar pjesërisht duhet më shumë punë për realizimin e tyre në nivelin 100% të rekomandimeve.

III. Zbatimi i Rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

III.1. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

I. Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A – UKT SH.A

Nga KLSH, me shkresën nr. 968/10 prot, datë 03.04.2023 për përmirësimin e gjendjes, janë rekomanduar 15 masa organizative. Nga masat organizative janë pranuar plotësisht 15 masa organizative. Janë zbatuar 5 masa organizative, janë në proces zbatimi 7 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative.

III.2 Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 968/10 prot, datë 03.04.2023, është dërguar “Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A. UKT SH.A me shkresën nr. U150/3, datë 26.05.2023 ka dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit planin e masave për rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi auditimin e zhvilluar në Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, duke mos respektuar afatin prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

III.3 Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 968/10 prot, datë 03.04.2023, është dërguar “Raporti

Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A.UKT SH.A nuk ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar afatin prej 6 muajsh, në përputhje me pikën 2 të nenit 30, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

III.4 Realizimi i rekomandimeve, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

Nga të pranuarat	Nr.	%
Zbatuar	5	33
Zbatuar pjesërisht	-	-
Në proces	7	47
Nuk janë zbatuar	3	20

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse në auditimin e mëparshëm për përmirësimin e gjendjes janë lënë gjithsej **15** masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht **15** masa ose **100%** masa organizative. Janë zbatuar plotësisht **5** masa ose **33%** masa organizative, janë në proces zbatimi **7** ose **47%** masa organizative dhe janë pa zbatuar **3** masa ose **20%** masa organizative.

Më hollësisht, auditimi i zbatimit të rekomandimeve:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi aktet e brendshëm rregullativë, u konstatua se shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A nuk disponon një strategji institucionale si dhe një strategji mbi teknologjinë e informacionit, mungesa e të cilave sjell mangësi në vendosjen e prioritetëve të institucionit, politikave të sigurisë si dhe përmirësimin e infrastrukturës të TI të cilat do duhet të jenë në mbështetje të objektivave institucionale.

1.1.Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A, duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimeve që ofron, duhet të marrë masa për identifikimin, hartimin dhe zhvillimin e elementëve strategjikë në Teknologjinë e Informacionit që mbështesin strategjinë institucionale, ku nevojiten të merren në konsideratë të gjitha proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit, por nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument për të vërtetuar zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi nuk është zbatuar

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka një plan mbi trajnimin e stafit të TI në fusha specifike të cilat do të ndihmonin në rritjen profesionale dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre me qëllim përmbushjen e detyrave në nivel të lartë profesional. Po ashtu, është konstatuar se specialistët e TI nuk kanë zhvilluar trajnime, kualifikime profesionale brenda apo jashtë vendit, gjatë periudhës objekt auditimi.

2.1.Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnime profesionale teknike të punonjësve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, si një mënyrë që nxit dhe përmirëson kryerjen e detyrave me nivel të lartë profesional. Trajnimet mbi teknologjinë e informacionit nevojitet të kryhen dhe tek punonjësit e tjerë, duke pasur parasysh elementët më të rëndësishëm si ruajtja e të dhënave, të drejtat dhe detyrimet mbi mjetet teknologjike që disponon institucioni dhe ka vënë në përdorim të punonjësve.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka marrë masa për zbatimin e rekomandimit, duke bërë identifikimin e nevojave për trajnime të punonjësve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe duke i bërë pjesë të buxhetit të vitit 2024.

Rekomandimi është zbatuar

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A nuk disponon regjistër risku për periudhën objekt auditimi lidhur me teknologjinë e informacionit.

3.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për identifikimin dhe hartimin e regjistrit të riskut lidhur me teknologjinë e informacionit me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e tyre, si një mënyrë për të minimizuar problematika të mundshme që lidhen me teknologjinë dhe përdorimin e saj.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A. ka marrë masa për hartimin dhe miratimin e regjistrit të riskut me anë të Vendimit nr. 2, datë 28.02.2023 “Për miratimin e rregjistrit të riskut të hoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SH.A”për vitin 2023”.

Rekomandimi është zbatuar

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit zhvilluar në drejtim të teknologjisë së informacionit për pajisje kompjuterike, licenca dhe mirëmbajtje, u konstatua se:

- Specifikimet teknike që janë bërë pjesë e dokumenteve të tenderit, nuk janë hartuar nga grupet e ngritura për këtë qëllim dhe në përputhje me dispozitat ligjore si dhe urdhrat e brendshëm.
- Metoda e përdorur për përlllogaritjen e fondit limit, bazuar në çmimet e tregut nuk është dokumentuar dhe argumentuar plotësisht në përputhje në përcaktimet e dispozitave ligjore.
- Kërkesat e vendosura mbi kapacitetin teknik nuk janë argumentuar nga ana teknike, por vetëm nga ana ligjore, çfarë është në kundërshtim me nenin 61, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikuar në nenin 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
- Raportet periodike të mirëmbajtjes nuk janë dokumentuar në përputhje me specifikimet teknike që janë pjesë integrale e tyre.

4.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për:

- Hartimin e specifikimeve teknike në prokurime të teknologjisë së informacionit, të cilat duhet të dokumentohen dhe argumentohen për çdo procedurë, përpara përlllogaritjes së fondit limit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ky dokument të nevojitet të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.
- Njësia përgjegjëse për prokurimet në teknologjinë e informacionit, në përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, të marrë në konsideratë specifikime teknike të hartuara nga strukturat e ngritura për këtë qëllim. Në rastet e mungesës së kësaj strukture, specifikimet teknike përlllogaritja e fondit limit, kapaciteti teknik, grafiku i lëvrimit apo hartimi i kritereve, nevojiten të hartohen nga vetë njësia.
- Dokumentimin dhe argumentimin e mënyrës së zgjedhur në llogaritjen e fondit limit, për procedura të zhvilluara për teknologjinë e informacionit. Ky dokument të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.
- Argumentimin teknik dhe ligjor të çdo kërkesë të vendosur në kapacitetin teknik, për procedurat e prokurimit që lidhen me teknologjinë e informacionit. Ky dokument të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.
- Ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të shërbimeve të mirëmbajtjes në teknologjinë e informacionit, në përputhje me kërkesat e parashikuara në specifikimet teknike, duke dokumentuar në këtë mënyrë të plotë gjurmën e shërbimit të realizuar nga ofruesi.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A e ka pranuar dhe ka marrë masa për zbatimin e rekomandimit.

Rekomandimi është zbatuar

4.2.Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për përzgjedhjen dhe zhvillimin e trajnimeve specifike të zyrtarëve pjesëmarrës në procedurat e prokurimit si dhe për raste të veçanta të kërkojë nga APP mendime paraprake për trajnimin e tyre me qëllim realizimin e procedurave në vijimësi në përputhje me dispozitat ligjore.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe është marrë angazhimi për ta përmbushur atë, ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemet informatike që disponon Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A, u konstatua se të dhënat e abonentëve, matësve si dhe faturim-arkëtimit e administron me sistemin informatik “Billing”, por nuk disponon asnjë nga dokumentacionet e mëposhtme:

- Rregullore mbi përdorimin e sistemit;
- Rregullore operacionale mbi veprimet sistemuese që kryhen në sistem dhe bazën e të dhënave;
- Manual përdorimi;
- Diagramet e qarkullimit të informacionit;
- Kodin në burim;
- Dokumentacion udhëzues i ndërtimit.

5.1.Rekomandimi: Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e rregullores dhe manualit të përdorimit për sistemin informatik të faturim-arkëtimit në të cilat të përcaktohen detyrimet dhe rëndësia e veprimeve në këtë sistem, për çdo përdorues punonjës të institucionit që e akseson atë. Gjithashtu, të dokumentohen diagramet e qarkullimit të informacionit për secilin nga proceset që nis dhe përfundon nëpërmjet sistemit informatik të faturim - arkëtimit, duke siguruar në këtë mënyrë gjurmën e proceseve që kryhen nëpërmjet sistemit.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit, por duke qënë se, afati për zbatimin e tij është brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023 dhe UKT SH.A nuk ka dhënë dokumentacion justifikues në versione draft, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

5.2.Rekomandimi: Ujësjetës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e rregullores për veprimet operacionale, që nevojitet të kryhen në sistemin informatik për efekte sistemuese të shkaktuara nga gabimet njerëzore apo pamundësitë e njohura të sistemit nëpërmjet ndërfaqeve të sistemit. Për secilin prej ndryshimeve të parashikuara në rregullore të hartohen dhe miratohen formatet që sigurojnë gjurmën e veprimeve të kryera dhe të autorizuara sipas nevojës. Në këtë rregullore mund të përfshihen gjithashtu veprimet operacionale për pezullim të përkohshëm apo të përhershëm të aksesit të përdoruesve të jashtëm, dokumentimi i lidhjeve të reja, monitorimin periodik, që tregojnë për nivelin e aksesimit në sistemin informatik nga palët e treta që ofrojnë shërbime faturim – arkëtimi, për llogari të institucionit.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit, por duke qënë se, afati për zbatimin e tij është brenda 6-mujorit të parë të vitit 2023 dhe UKT SH.A nuk ka dhënë dokumentacion justifikues në versione draft, ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Rekomandimi nuk është zbatuar

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi gjurmën elektronike të auditimit u konstatua se nuk gjenerohet gjurmë mbi veprimet që kryejnë përdoruesit e bazës së të dhënave.

Për përdoruesit e sistemit nga ndërfaqja, ruhen të dhëna të pakta që janë: hyrja, dalja, IP e përdoruesit si dhe mënyra e daljes nga sistemi. Kjo gjurmë elektronike është e pamjaftueshme, për të siguruar të dhëna mbi aktivitetin e tyre. Në të dhënat e faturimit për periudhën objekt auditimi u konstatua vetëm në një rast për një kontratë të caktuar, mungojnë rekordet e faturimit, çfarë tregon mundësinë për ndërhyrje në bazën e të dhënave.

6.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e politikave të sigurisë së të dhënave që aksesojnë përdoruesit e jashtëm dhe të brendshëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe është marrë angazhimi për ta përmbushur me anë të procedurës që është ende në prokurim me objekt: *“Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”*. Ky rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces

6.2.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa teknike për sistemimin e gjurmës elektronike të auditimit në sistemin informatik të faturim-arkëtimit, si e vetmja mënyrë që siguron gjurmueshmërinë e të dhënave elektronike në rast të kundra vajtjeve administrative dhe operacionale.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe është marrë angazhimi për ta përmbushur me anë të procedurës që është ende në prokurim me objekt: *“Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”*. Ky rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdoruesit në bazën e të dhënave u konstatua se për drejtorin e IT-s janë aktivë dy përdorues të krijuar në bazën e të dhënave, si dhe vazhdon të jenë aktive përdoruesit e operatorit që ka ofruar shërbim të mirëmbajtjes së sistemit të faturim-arkëtimit, megjithëse kontrata për këtë shërbim ka përfunduar.

7.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për dokumentimin e përdoruesve të krijuar në bazën e të dhënave si dhe mbylljen e atyre që nuk janë duke ushtruar detyra funksionale që lidhen me shërbimin e mirëmbajtjes së sistemeve që disponon institucioni.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka marrë masa për zbatimin e rekomandimit duke dokumentuar formularët përkatës për përdoruesit që krijohen/mbyllet në bazën e të dhënave të sistemeve që disponon institucioni.

Rekomandimi është zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentimin e VPN-ve të konfiguruar, u konstatua se:

- Kontratat e Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A me palët e treta nuk përmbajnë detaje teknike mbi implementimin, zbatimin dhe ndjekjen e kontratës;
- Disa nga operatorët privatë që aksesojnë të dhënat e sistemit të Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, u konstatua se kanë më shumë se një llogari VPN aktive, ndërsa nuk ka gjurmë dokumentare nëse janë miratuar lidhjet e dyta si dhe arsyet që kanë lindur për këtë konfigurim.

- UKT nuk ka ushtruar kontrole periodike mbi VPN që janë vënë në dispozicion të palëve të treta me qëllim kontrollin në çdo përpjekje autentifikimi, të dështuar ose të suksesshme, kohën dhe datën e secilës lidhje dhe shkëputje si dhe jo pak e rëndësishme sasia e të dhënave të transmetuara në çdo sesion.

- VPN dhe përdorues database të operatorit që ka ofruar shërbim mirëmbajtje, u konstatua të jenë aktive në sistem, megjithëse kontrata për shërbimin e mirëmbajtjes ka përfunduar.

Në kontratat me palët e treta për lidhjet VPN, nuk përcaktohen kushtet teknike, mënyrat e raportimit, kontrollet periodike që do të ushtrohen, penalitete të mundshme, persona kontakti teknik të dy palëve, etj., me qëllim informimin dhe adresimin e problematikave nga aksesime jo të sigurta.

8.1.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për rinovimin e kontratave me palët e treta që ofrojnë shërbime faturim – arkëtimi për llogari të institucionit nëpërmjet lidhjeve me VPN, në të cilën të bëhen pjesë detaje teknike mbi implementimin, zbatimin dhe ndjekjen e tyre.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe ka ndërmarrë hapa për ta përmbushur atë, konkretisht, Departamenti i Administrimit të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit ka dërguar shkresën nr. 742, datë 20.02.2024, Departamentit Ligjor dhe të Prokurimeve, Drejtorisë Ekonomike dhe Departamentit të Shitjes me anë të së cilës kërkohet rikonfirmimi të kontratave aktive me palët e treta. Ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

8.2.Rekomandimi: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për monitorimin, pezullimin apo mbylljen në rast se do të jetë e nevojshme të lidhjeve aktive të VPN me të cilët nuk disponojnë një kontratë bashkëpunimi apo shërbimi.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe ka ndërmarrë hapa për ta përmbushur atë, konkretisht, Departamenti i Administrimit të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit ka dërguar shkresën nr. 742, datë 20.02.2024, Departamentit Ligjor dhe të Prokurimeve, Drejtorisë Ekonomike dhe Departamentit të Shitjes me anë të së cilës kërkohet rikonfirmimi të kontratave aktive me palët e treta. Ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi.

Rekomandimi është në proces

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e përdoruesve të sistemit “Billing” u konstatua se:

- Për përdoruesin me të drejta të plota, në rolin e administratorit, nuk ka të dhëna të punonjësit që posedon këtë llogari;

- Janë aktiv katër përdorues me kredenciale të pa identifikuar që janë: njësia nr.1, njësia nr.2, njësia nr.3, njësia nr.4;

- Në shumë raste të krijimit të përdoruesve, nuk janë ruajtur të plota gjurmët se kush nga përdoruesit ka kryer veprimin;

- Në disa raste një punonjës ka më shumë se një llogari aktive në sistem;

- Fjalëkalimi i secilit përdorues në sistemin Billing në momentin e krijimit është standard, kur përdoruesi logohet për herë të parë (first log-in) ndryshimi i fjalëkalimit fillestar nuk kërkohet në mënyrë të detyrueshme të ndryshohet. Ky ndryshim mbetet në dëshirën apo njohuritë e punonjësit;

- Funkcionalitetet e përdoruesve në sistem nuk janë të paracaktuara me rolin që i caktohet, ato përzgjidhen manualisht nga punonjësi që zbaton kërkesën për krijimin e llogarisë së re;

- Fjalëkalimi në sistemin Billing nuk është i parametrizuar për nga kompleksiteti dhe gjatësia e tij. Për kriteret e fjalëkalimit të përdoruesve fundor nuk janë hartuar apo implementuar standarde me qëllim forcimin e tij.
- Nga auditimi dhe mbikëqyrja e faqes Web u konstatua se portali nuk përdor një lidhje të sigurtë HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure), pra komunikimi ndërmjet web browser-it dhe serverit kryhet duke përdorur protokollin HTTP, që do të thotë se serveri i faqes së internetit nuk përdor një certifikatë sigurie për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletues.

9.1.Rekomandimi: Ujësjesllës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e politikave mbi fjalëkalimin e përdoruesve në sistemin “Billing” ku të përcaktohet kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra si dhe periodiciteti për ndryshimin e tij. Gjithashtu, të merren masa për hartimin dhe miratimin e rregullores për krijimin dhe administrimin e përdoruesve të brendshëm, ku të jenë pasqyruar saktë të drejtat dhe detyrimet që kanë përdoruesit mbi funksionalitetet e sistemit informatik “Billing”.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe është marrë angazhimi për ta përmbushur me anë të procedurës që është ende në prokurim me objekt: “Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”. Ky rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces

9.2.Rekomandimi: Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit të konsiderojë, ndryshimin e fjalëkalimit me forcë nëpërmjet opsionit “Ndrysho fjalëkalimin në log-imin e radhës”, me qëllim rritjen e sigurisë në përdoruesit e brendshëm.

Nga auditimi rezulton se: Në lidhje me këtë rekomandim, u vërtetua me printscreen përkatës se UKT SH.A ka marrë masa për ndryshimin e fjalëkalimit me forcë nëpërmjet opsionit “Ndrysho fjalëkalimin në log-imin e radhës”.

Rekomandimi është zbatuar

9.3.Rekomandimi: Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, të marrë masa për vendosjen e certifikatës së sigurisë HTTPS (HyperText Transfer Protocol Secure) në mënyrë që të krijohet një kanal i sigurt për aksesimin e sistemit të faturim-arkëtimit “Billing”.

Nga auditimi rezulton se: UKT SH.A ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe është marrë angazhimi për ta përmbushur me anë të procedurës që është ende në prokurim me objekt: “Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe sigurisë, moduleve të taksave, leximeve dhe pagesave me palët e treta, mirëmbajtje dhe monitorim i sigurisë së sistemit dhe moduleve”. Ky rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Akt Verifikimi nr. 2, datë 29.02.2024 protokolluar në UKT SHA me nr. K-375/2 prot datë 29.02.2024, si dhe është trajtuar në faqet 3-14 të Projekt Raportit të Auditimit “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara 6-mujorin e parë të vitit 2023” mbi të cilin nuk janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit.

Përmbledhëse e Masave

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa Organizative	15	15	5	-	7	3

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes UKT SH.A i janë rekomanduar 15 masa organizative. Nga auditimi rezultoi se, nga masat organizative janë zbatuar 5 masa masa organizative, janë në proces zbatimi 7 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 3 masa organizative. Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 968/10 prot, datë 03.04.2023 drejtuar UKT SH.A, **nuk janë zbatuar rekomandimet (1.1, 5.1, 5.2), si vijon:**

1.1.Rekomandimi: Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A, duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimeve që ofron, duhet të marrë masa për identifikimin, hartimin dhe zhvillimin e elementëve strategjikë në Teknologjinë e Informacionit që mbështesin strategjinë institucionale, ku nevojiten të merren në konsideratë të gjitha proceset për zhvillimin, aprovimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e strategjisë.

5.1.Rekomandimi: Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e rregullores dhe manualit të përdorimit për sistemin informatik të faturim-arkëtimit në të cilat të përcaktohen detyrimet dhe rëndësia e veprimeve në këtë sistem, për çdo përdorues punonjës të institucionit që e akseson atë. Gjithashtu, të dokumentohen diagramet e qarkullimit të informacionit për secilin nga proceset që nis dhe përfundon nëpërmjet sistemit informatik të faturim - arkëtimit, duke siguruar në këtë mënyrë gjurmën e proceseve që kryhen nëpërmjet sistemit.

5.2.Rekomandimi: Ujësjiellës Kanalizime Tiranë Sh.A, të marrë masa për hartimin e rregullores për veprimet operacionale, që nevojitet të kryhen në sistemin informatik për efekte sistemuese të shkaktuara nga gabimet njerëzore apo pamundësitë e njohura të sistemit nëpërmjet ndërfaqeve të sistemit. Për secilin prej ndryshimeve të parashikuara në rregullore të hartohen dhe miratohen formatet që sigurojnë gjurmën e veprimeve të kryera dhe të autorizuara sipas nevojës. Në këtë rregullore mund të përfshihen gjithashtu veprimet operacionale për pezullim të përkohshëm apo të përhershëm të aksesit të përdoruesve të jashtëm, dokumentimi i lidhjeve të reja, monitorimin periodik, që tregojnë për nivelin e aksesimit në sistemin informatik nga palët e treta që ofrojnë shërbime faturim – arkëtimit, për llogari të institucionit.

1.1.Rekomandimi: Strukturat përkatëse të UKT SH.A, të marrin masat e nevojshme për rekomandimet që nuk janë zbatuar me qëllim përsheptimin për zbatimin e tyre.

Brenda 3 mujorit të II të vitit 2024 dhe në vijimësi

Të tjera

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajohet përsheptimi i realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2024, verifikimi i zbatimit të të cilave do të kryhet në auditimin e radhës që KLSH do kryejë në këto subjekte.

Për rekomandimet të cilat kanë rezultuar të pazbatuara nga auditimi i ushtruar “*Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2023*”, së bashku me pjesë nga Raporti Përfundimtar, do të përcillen në subjekt sipas Vendimit të Kryetarit për këtë auditim.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT